



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 359 Akti

Nr. 434 Vendimi
Tiranë, më 7.9.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj Kryesuese
Lulzim Hamitaj Relator
Genta Tafa (Bungo) Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 2.9.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Adelajda Gjuzi**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Adelajda Gjuzi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 2.9.2021, kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Znj. Adelajda Gjuzi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në: Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); si dhe pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).
- ii. Pika 4, e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio”*.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit Adelajda Gjuzi, procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Alma Faskaj.
- iv. Trupi gjykues i sipërpërmendur, pasi administroi dhe shqyrtoi të tria raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31- 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 19.12.2019, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të po këtij ligji; dhe (ii) me mirëkuptim, të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Alma Faskaj. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
- v. Pasi ishte përfunduar faza hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Adelajda Gjuzi, me vendimin nr. 2, datë 13.7.2021, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
- vi. Komisioni, në datën 15.7.2021, e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht – duke e ftuar për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur qëndrimin e saj.

- vii. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet mbi rezultatet e hetimit kryesisht në afatin e përcaktuar nga Komisioni. Në vijim, në datën 31.8.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë, përmes postës elektronike, subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore të caktuar në datën 2.9.2021, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Adelajda Gjuzi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit.
- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti i rivlerësimit Adelajda Gjuzi, ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim.
- iii. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iv. Seanca dëgjimore e datës 2.9.2021 u mbyll, për të rifilluar më 7.9.2021, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLGJ-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (ix) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaramëve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaramëve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

A/2. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

1. Apartament banimi, me sipërfaqe 108,6 m², në rrugën “S. e V.”, Tiranë

1. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri, në DIPP-në e vitit 2014, si dhe në deklaratën *Vetting*, me vlerë 8,680,000 lekë, e cila ishte përfituar fillimisht nga shtetasi V. Ç., nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 21.11.2012, të lidhur me shoqërinë “R.” sh.p.k., për shkak dhe si rezultat i punimeve¹ të kryera nga ky shtetas, në favor të shoqërisë ndërtuese. Në kontratën përkatëse ishte rënë dakord paraprakisht se vlera e apartamentit në fjalë do të ishte 83,720 euro (ekuivalenti prej 11,697,358 lekësh²) dhe do të likuidohet me punë duke iu referuar kontratës që palët kishin lidhur me objekt kryerjen e punimeve rifiniturë.
2. Në vijim, nëpërmjet kontratës³ nr. ***, datë 24.6.2014, shtetasit V. Ç. dhe M. Ç., në cilësinë e palës shitëse i kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet për këtë pasuri, palës blerëse/shtetasit Q.Gj.⁴, kundrejt çmimit prej 8,680,000 lekë, rreth 3,017,358 lekë më lirë se vlerësimi i sipërcituar i këtij apartamenti.
3. Përgjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, ka rezultuar se shuma prej 7,000,000 lekësh është likuiduar nga bashkëshorti i subjektit, shtetasi Q. Gj., në momentin e nënshkrimit të kontratës⁵. Si burim financiar për krijimin e kësaj shume kanë shërbyer gjendjet në llogaritë bankare në “Raiffeisen Bank” dhe “Alpha Bank”. Për sa i përket diferencës së mbetur në shumën prej 1,680,000 lekësh, është dakordësuar mes palëve se ajo do të konsiderohet si

¹Subjekti ka paraqitur edhe deklaratën nr. ***, datë 26.2.2021, në të cilën shtetasi V. Ç. ka deklaruar mënyrën e përfitimit të pasurisë.

²Referuar kursit mesatar të këmbimit të fundit të vitit 2012.

³Në këtë kontratë, shoqëria “R.” sh.p.k., ka qenë në cilësinë e personit që ka dijani, për marrëdhënien kontraktuale të sipërcituar.

⁴Bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

⁵Kontrata për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve nr. ***, e datës 24.6.2014.

hua dhe do të likuidohej gradualisht, deri në momentin e pajisjes së blerësit me certifikatën e pronësisë⁶.

4. Gjithashtu, nga hetimi ka rezultuar se blerja e kësaj pasurie, është finalizuar nëpërmjet kontratës nr. ***, datë 15.7.2015, me anë të së cilës, pala shitëse shoqëria “R.” sh.p.k., i ka dorëzuar sendin palës blerëse, bashkëshortit të subjektit. Në këtë kontratë palët kanë deklaruar se çmimi i shitjes prej 8,680,000 lekësh është likuiduar tërësisht sipas kontratës së kalimit të të drejtave dhe detyrimeve të vitit 2014.
5. Komisioni, në funksion të kryerjes së hetimit të plotë dhe të gjithanshëm administrativ, me qëllim verifikimin e ekzistencës së mundshme të konfliktit të interesave, ka kërkuar informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat⁷. Gjithashtu, Komisioni i ka kërkuar subjektit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, të sqarojë marrëdhënien me shtetasit M. Ç., V. Ç. dhe shoqërinë “R.” sh.p.k., si dhe ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesave me këta shtetas. Nga hetimi i kryer nuk ka rezultuar konflikt interesi midis subjektit dhe palës shitëse të apartamentit në fjalë.
6. Nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 11.3.2020, Ministria e Drejtësisë, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira, Regjistri Noterial, ka konfirmuar ekzistencën e regjistrimit të kontratave me të dhënat e përshkruara më sipër.
7. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni është informuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës⁸, e cila ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar pasuri të paluajtshme të regjistruara në pronësi të subjektit apo personave të lidhur me të, veç asaj të deklaruar nga subjekti. Gjithashtu, Komisioni ka kryer edhe një verifikim *on-line*, në sistemin multifunksional të ASHK-së për institucionet, përmes së cilit është konfirmuar i njëjti informacion/konstatim i përcjellë⁹.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

8. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, për këtë pasuri, përveç dokumentacionit që ka depozituar së bashku me prapësimet, si dhe përgjatë seancës dëgjimore, ndër të tjera, ka shpjeguar se: [...] *“Ulja e çmimit të blerjes së pasurisë rreth 3,000,000 lekë më lirë se vlera e këtij apartamenti përfituar nga vetë pala shitëse, ka ardhur si pasojë e përfitimit të apartamentit, prej tij, me klering, kundrejt kryerjes së punimeve të tilla si lysterje, grafiato, kartonxhes etj., në favor të investitorit. [...]”*
9. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur disa kontrata shitblerjeje të apartamenteve të ndodhur në të njëjtin pallat, për të provuar ekzistencën e transaksioneve të tjera të kryera nga e njëjta shoqëri me çmime edhe më të ulëta se çmimi i apartamentit të blerë prej bashkëshortit të saj.

⁶Deklaratë noteriale nr. ***, të datës 15.7.2015, në të cilën shtetasi V. Ç. së bashku me bashkëshortin e subjektit kanë deklaruar se kësti i dytë në shumën 1,680,000 lekë do të likuidohet gradualisht dhe se për efekt të nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes, ky këst do të trajtohet si një hua ndërmjet tyre.

⁷Me shkresat nr. *** prot., datë 19.5.2021 dhe nr. *** prot., datë 19.5.2021.

⁸Shkresat nr. *** prot., datë 6.3.2020; nr. *** prot., datë 7.4.2020; si dhe nr. *** prot., datë 28.2.2021.

⁹Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, ka rezultuar se babai i bashkëshortit të subjektit, shtetasi I. Gj., ka aplikuar në procesin e legalizimit me nr. *** prot., datë 23.12.2014, në Elbasan, si dhe kanë blerë një pasuri të paluajtshme, po në Elbasan, në datën 23.02.2016, për të cilat ASHK-ja Elbasan nuk ka paraqitur dokumentacionin përkatës.

Vlerësimi i trupit gjykues

10. Lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, nga shqyrtimi i kontratave të paraqitura në cilësinë e provës nga subjekti, ka rezultuar se apartamentet në pallatin në të cilin ndodhet pasuria në analizë, janë shitur me çmime nga 400 euro/m² deri në 663 euro/m². Ndërkohë që bashkëshorti i subjektit e ka blerë atë kundrejt çmimit 581 euro/m², vlerë e cila është më e lartë se çmimi mesatar i shitjes.
11. Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë edhe kontratat tip të administruara, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti përgjatë seancës dëgjimore, trupi gjykues vlerëson se subjekti dhe bashkëshorti, me blerjen e kësaj pasurie, nuk kanë përfituar pasuri më shumë nga sa kanë paguar, si dhe çmon se nuk ka pasur ndonjë trajtim preferencial apo ndonjë përfitim të dyshimtë lidhur me dinamikën e marrëdhënies juridiko-civile, pasi nuk rezultoi që ky transaksion të jetë influencuar nga ekzistenca e njohjes apo e marrëdhënieve të mëhershme mes palëve dhe aq më pak për shkak të detyrës së subjektit.
12. Për rrjedhojë, shpjegimet e subjektit, lidhur me shkaqet e përfitimit të apartamentit në fjalë me një vlerë më të ulët nga sa ishte vlerësuar në kontratën midis ndërtuesit dhe shitësit, në një marrëdhënie *kleringu*, konsiderohen bindëse, për sa kohë shitësi e kishte përfituar nëpërmjet kryerjes së punimeve dhe kjo rrethanë i ka lejuar këtij të fundit një marzh fitimi dhe/ose negocimi më të gjerë mbi çmimin në analizë. Kësisoj, për sa kohë shpenzimi rezulton proporcionalisht në raport të drejtë me investimin, duke iu referuar edhe çmimeve të përshkruara në kontratat shitblerjeve për disa pasuri të ngjashme, fakti se shitësi e ka tjetërsuar pasurinë në fjalë me një çmim më të ulët nga sa ishte vlerësuar paraprakisht me ndërtuesin, nuk do të thotë se atij vetë i ka kushtuar në atë masë, pasi faturimi i punimeve të kryera ka pas brenda marzhin e fitimit prej tij. Gjithsesi, trupi gjykues çmon se kjo diferencë – në mungesë të konstatimit të ekzistencës konkrete të trajtimit preferencial, të ndërthurur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi, apo të induktuar nga pozicioni funksional i subjektit – nuk mund të përbëjë rrethana gjeneruese të ndonjë përgjegjësie të subjektit të rivlerësimit.

1.1. Analiza e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

13. Në deklaratën e vitit 2014, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar lidhjen e kontratës për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve lidhur me këtë pasuri, si dhe kryerjen e pagesës në vlerën 7,000,000 lekë, nga llogaritë e tij në “Alpha Bank” dhe në “Raiffeisen Bank”. Po ashtu, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar edhe pakësimet në gjendjet e llogarive të tij bankare duke përshkruar kështu burimet përkatëse të përdorura. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë nga kursimet familjare, hua dhe dhuratë nga prindërit e bashkëshortit (deklaruar nga bashkëshorti), në vlerën 3,000,000 lekë. Në seksionin e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar huan pa afat sipas deklaratës noteriale së datës 15.7.2015, me vlerë të mbetur prej 1,127,000 lekësh¹⁰.
14. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, si dhe nga deklaratimet e subjektit, ka rezultuar se pagesa e këstit të parë në shumën 7,000,000 lekë është kryer si vijon:

¹⁰Subjekti ka shpjeguar se nga shuma e huas 1,680,000 lekë është shlyer shuma 2,000 euro në datën 1.2.2016 dhe shuma 273,000 lekë në datën 30.3.2016, me burim nga kursimet e bashkëshortit.

- shuma 5,001,500 lekë është transferuar në datën 13.6.2014, nga llogaria e bashkëshortit të subjektit në “Raiffeisen Bank”, në favor të noteres M. Sh.;
 - shuma 10,000 euro është tërhequr nga llogaria e bashkëshortit në “Raiffeisen Bank” në datën 13.6.2014 dhe është derdhur, po në këtë datë, në llogari të noteres; si dhe
 - shuma 600,500 lekë është transferuar në datën 16.6.2014, nga llogaria e bashkëshortit të subjektit në “Alpha Bank”, në favor të noteres M. Sh..
15. Ndonëse transfertat/veprimet e mësipërme bankare, janë kryer nga llogaritë e bashkëshortit të subjektit, është konstatuar se shumat prej 3,000,000 lekësh (pjesë e shumës prej 5,000,000 lekësh), si dhe shuma prej 8,000 euro (pjesë e shumës prej 10,000 euro) në “Raiffeisen Bank”, kanë qenë dhurime të mëhershme, të kryera nga prindërit e bashkëshortit të subjektit, të transferuara në favor të këtij të fundit, të cilat janë analizuar në vijim.

Në lidhje me pagesën në shumën prej 5,000,000 lekësh nga “Raiffeisen Bank”

16. Nga analiza e lëvizjeve në llogaritë bankare ka rezultuar se shuma prej 5,000,000 lekësh është krijuar nga kursime të bashkëshortit të subjektit në shumën 2,000,000 lekë dhe dhurimi nga prindërit në shumën 3,000,000 lekë.
17. Shuma prej 2,000,000 lekësh rezulton të jetë krijuar nga depozitimet *cash* gradualisht në llogarinë e tij prej vitit 2006 deri në fund të vitit 2012, në shumën 1,786,000 lekë, një derdhje *cash* në shumën 70,000 lekë nga shtetasi M. E.¹¹, hua në shumën 50,000 lekë nga shtetasi A. F. dhe nga të ardhurat nga interesat bankare ndër vite.
18. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka parashtruar se kjo shumë është krijuar me kursimet e bashkëshortit nga punësimet: përgjatë periudhës 1.6.2006 – 31.10.2007 pranë personit fizik “J. Z.”; të ardhura në vlerën rreth 500,000 lekë të dhuruara nga babai i tij, për ndihmën e dhënë në kryerjen e punëve në dyqanin e këtij të fundit; të ardhurat nga pagat e tij nga shoqëria “D.” sh.p.k., për periudhën 2009 – 2012; si dhe të ardhurat e subjektit nga bursa në Shkollën e Magjistraturës.
19. Komisioni ka hetuar mbi mundësitë e subjektit dhe bashkëshortit, për të depozituar fondet e lartpërmendura, me burime të ligjshme financiare. Nga dokumentacioni i administruar, ka rezultuar se të ardhurat nga pagat e subjektit dhe bashkëshortit përgjatë periudhës 2006 – 2012 kanë qenë në vlerën 1,099,460 lekë¹², shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë kanë qenë në vlerën 2,760,449 lekë, si dhe është depozituar shuma prej 1,786,000 lekësh. Nga kjo analizë, ka rezultuar pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare, për të

¹¹Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se shtetasi M. E. dhe A. F. janë miq të bashkëshortit, të cilët kanë ndihmuar me këto shuma, me qëllim blerjen e apartamentit prej tyre. Subjekti ka paraqitur së bashku me përgjigjet e mësipërme edhe deklaratimet e tyre noteriale për transferimin e shumave të mësipërme, si dhe vërtetimet për bazën e vlerësuar mbi të ardhurat e secilit.

¹²Në këtë përlogaritje janë përfshirë të ardhurat e bashkëshortit të subjektit “J. Z.” Person Fizik, për të cilat ISSH-ja Drejtoria e Arkivit të Rajonit Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 8.7.2021, ka bërë me dije se shtetasi Q. Gj. ka qenë i siguar pranë kësaj shoqërie për periudhën tetor 2006 – dhjetor 2007 dhe ka përfituar të ardhurat *bruto* prej 207,000 lekësh, në bazë të të cilave janë derdhur kontributet. Ndërkohë, lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit pranë shoqërisë “D.” sh.p.k., në deklaratimet e subjektit është pretenduar punësimi prej datës 1.1.2009, ndërkohë informacioni i ardhur nga ISSH-ja me anë të shkresës nr. *** prot, datë 25.2.2020, referon të dhënat prej muajit janar të vitit 2012. Komisioni, për periudhën 1.1.2009 – 2012, i ka kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale të ISSH-së Durrës, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 1.7.2021, për të bërë me dije mbi të ardhurat nga paga të bashkëshortit të subjektit, mbi të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përgjigja e së cilës nuk ka mbërritur ende. Për rrjedhojë, këto të ardhura janë konsideruar për momentin, me rezervë.

gjithë shumën e depozituar prej 1,786,000 lekësh, për të cilën subjektit i ka kaluar barra e provës.

20. Gjithashtu, nga historiku i lëvizjeve në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit, ka rezultuar se shuma prej 3,000,000 lekësh është transferuar në favor të tij nga llogaria e përbashkët e prindërve në BKT, në datën 06.06.2014, me përshkrimin “kalim për blerje apartamenti”. Nga analizimi i lëvizjeve në llogarinë e përbashkët bankare të prindërve të bashkëshortit të subjektit, ka rezultuar se kjo shumë është krijuar nga depozitime të kryera në *cash* nga vjehri i subjektit, si vijon:
- shumën 1,000,000 lekë në datën 7.2.2007;
 - shumën 1,500,000 lekë në datën 2.5.2007;
 - shumën 1,000,000 lekë në datën 5.12.2007;
 - shumën 1,000,000 lekë në datën 31.12.2012¹³;
 - shumën 1,882,212 lekë në datë 14.05.2013¹⁴; si dhe
 - shumën 2,000,000 lekë të transferuar në datën 9.8.2013 nga shtetasi G. N. D.¹⁵, me përshkrimin “kthim huaje”.
21. Këto shuma janë investuar, ndër vite, nga prindërit e bashkëshortit të subjektit, në depozita me afat, duke krijuar edhe të ardhura nga interesat. Ndërkohë, nga një analizë e të gjitha llogarive të prindërve të bashkëshortit është konstatuar se janë kryer edhe depozitime të tjera *cash*, në llogari të bankave të tjera të disponuara prej tyre, deri në momentin e dhurimit, në shumën totale prej 10,432,827 lekësh, përveç atyre të përmendura më lart, si dhe është tërhequr shuma 6,776,854 lekë.
22. Komisioni ka hetuar mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personave të lidhur, në kuptim të përcaktimit të pikës 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Nga dokumentacioni i administruar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan¹⁶, ka rezultuar se prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, kanë ushtruar aktivitetet e tyre tregtare, përkatësisht Person Fizik “I. Gj.”¹⁷, i regjistruar në datë 1.2.2001 dhe Person Fizik “L. Gj.”¹⁸, e regjistruar në datën 26.2.2008.
23. Komisioni, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, të bëjë me dije mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të bashkëshortit të subjektit që kanë mundësuar dhurimet e kryera në favor të djalit të tyre.

¹³Kjo shumë është vendosur në depozitë me afat në datën 30.4.2013 dhe pas maturimit, është tërhequr prej vjehrit të subjektit, së bashku me interesat e fituara, shuma totale prej 1,007,715.19 lekësh. Në të njëjtën datë është konstatuar një derdhje e kryer në llogarinë e tij në “Tirana Bank”, e shumës 1,000,000 lekë, e cila ka vijuar të qëndrojë në këtë llogari së paku deri në vitin 2020.

¹⁴Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të prindërve të bashkëshortit të subjektit është konstatuar se në këtë datë ata kanë kryer një tërheqje në llogarinë e tyre në euro në BKT, të shumës prej 13,387 euro, e cila duket se përkon me ekuivalentin e shumës së derdhur në llogarinë në lekë prej 1,882,212 lekësh. Kjo shumë prej 13,387 euro është krijuar fillimisht nga depozitimet e kryera në *cash* nga vjehri i subjektit përkatësisht të shumave 8,000 euro në datën 8.4.2011 dhe 5,000 euro në datën 16.9.2011. Këto shuma janë investuar në depozita me afat duke realizuar të ardhura nga interesat në shumat 258.5 euro dhe 128.98 euro.

¹⁵Shtetasi G. D. rezultoi të jetë një nga aksionerët e shoqërisë “D.” sh.p.k. dhe “XH.” sh.p.k., në të cilat bashkëshorti i subjektit është i punësuar.

¹⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 17.3.2020, të DRT-së Elbasan.

¹⁷Objekti i aktivitetit është “tregti me pakicë e produkteve të tjera në dyqane të specializuara”.

¹⁸Sipas historikut të tatimpaguesit, objekti i aktivitetit është “tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara, me mbizotërim artikujsh ushqimorë, pije e duhan”.

24. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur vërtetimet nga ISSH Drejtoria Rajonale Elbasan, për pagat mbi të cilat janë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për prindërit e bashkëshortit. Nga dokumentacioni i paraqitur ka rezultuar se nëna e bashkëshortit, ka qenë e siguruar pranë aktivitetit të bashkëshortit “I. Gj.” person fizik deri në vitin 2007 dhe më pas nga viti 2008 tek aktiviteti i saj si person fizik “L. Gj.”.
25. Referuar përcaktimit të pikës 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, si dhe duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹⁹, dokumentacioni i lartpërmendur, provon pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve të të vetëpunësuarit, por nuk provon përfitimin real të të ardhurave nga pagat dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të cilësohen si të ardhura të ligjshme, pra nuk mund të përfshihen në përlllogaritjen e kursimeve familjare.
26. Sa i përket të ardhurave/fitimeve të realizuara nga aktivitetet tregtare të prindërve të bashkëshortit të subjektit, bazuar në dokumentacionin e administruar nga DRT-ja Elbasan²⁰ dhe Bashkia Elbasan²¹, subjekti ka paraqitur një raport të kryer nga një auditues ligjor. Në këtë raport është përlllogaritur fitimi *neto* i realizuar nga dy aktivitetet e tyre, për të gjithë periudhën 2001 – 2016, në vlerën totale prej 14,875,461 lekësh. Kjo përlllogaritje është kryer duke marrë në konsideratë edhe periudhat për të cilat mungojnë të dhënat tatimore mbi xhiron e realizuar apo fitimin, me një mesatare të marzhit të fitimit të vetëdeklaruar nga babai i bashkëshortit të subjektit dhe atij të vitit 2008 (që është viti i parë për të cilin ekzistojnë të dhëna si për xhiron/qarkullimin dhe për fitimin), si dhe duke prezumuar që nga viti 2009, sektori i ndërtimit ka pasur rënie si pasojë e krizës. Ndërsa, për aktivitetin e nënës së bashkëshortit është prezumuar pagesa e tatimit të fitimit sipas kategorisë, për vitet 2008 – 2013, për të cilën nuk kanë rezultuar të dhëna mbi pagesa të detyrimeve tatimore.
27. Gjithashtu, Komisioni ka kryer një përlllogaritje për fitimin *neto* të aktivitetit të vjehrrit të subjektit, duke marrë në konsideratë, vetëm ato periudha, për të cilat ndonëse nuk ka të dhëna mbi xhiron reale të realizuar, ka rezultuar i paguar tatimi mbi fitimin. Po ashtu, Komisioni, në mungesë të provave, ka marrë në konsideratë marzhin e fitimit për vitet në të cilat mungojnë të dhënat, bazuar në mesataren e marzhit për vitet të cilat janë të provuara, prej ~23%.

¹⁹Vendimi nr. 27 (JR), të vitit 2019.

²⁰Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2016, që tatimpaguesi “L. Gj.”, person fizik nuk ka detyrime tatimore; shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2016, që tatimpaguesi “I. Gj.”, person fizik nuk ka detyrime tatimore; shkresë nr. *** prot., datë 8.1.2020, mbi detyrimet e tatim-fitimit të paguar nga tatimpaguesi “L. Gj.” person fizik për vitet 2014 e në vijim dhe shkresë nr. *** prot., datë 8.1.2020, për detyrimet e tatim-fitimit të paguar nga tatimpaguesi “I. Gj.” person fizik duke filluar nga viti 2001.

²¹Vërtetim nr. *** prot., datë 9.1.2020, mbi xhirot e vetëdeklaruar nga “L. Gj.” person fizik për periudhën 2008 – 2013 dhe vërtetim nr. *** prot., datë 9.1.2020, mbi xhirot e vetëdeklaruar nga “I. Gj.” person fizik për periudhën 2006 – 2012.

Tabela nr. 1 – Të ardhura të aktivitetit “I. Gj.” person fizik

Viti	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2008	2009	2010	2011	2013	2014	2015	2016
Të ardhura / Qarkullimi	2 000 000	4 450 000	3 350 000	2 450 000	2 700 000	3 500 000	1 965 926	2 485 000	1 750 000	820 000	1 339 589	1 328 800	1 705 328	2 935 214
Shpenzime							-1 345 926	-2 144 135	-1 410 000	- 631 420	-1 137 651	-1 036 411	-1 394 356	-1 670 311
Fitimi Bruto	465 221	1 035 116	779 245	569 896	628 048	814 136	620 000	340 865	340 000	188 580	201 938	292 389	310 972	1 264 903
Tatim-fitimi	- 40 000	- 98 000	- 194 000	- 118 000	- 76 598	- 52 500	- 63 000	- 63 000	- 48 000	- 37 220	- 25 000	- 25 000	- 25 000	
Fitimi Neto	425 221	937 116	585 245	451 896	551 450	761 636	557 000	277 865	292 000	151 360	176 938	267 389	285 972	1 264 903
Marzhi fitimit bruto/qarkullimin	23%	23%	23%	23%	23%	23%	32%	14%	19%	23%	15%	22%	18%	43%

28. Ndërsa, për aktivitetin e vjehrrës së subjektit, për sa kohë nuk janë të provuara pagesat për tatimin mbi fitimin për vitet 2008 – 2013, përgjatë hetimit administrativ, nuk janë përfshirë në analizën financiare. Në përfundim të analizës ka rezultuar se prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë pasur të ardhura nga aktivitetet e tyre, për periudhën 2001 – 2016, shumën prej 7,874,504 lekësh.
29. Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit edhe vërtetimin mbi bazën e vlerësuar të shtetases B. Gj. B., motrës së bashkëshortit, më qëllim përfshirjen e të ardhurave të saj nga punësimi pranë Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, për periudhën 1.10.2011 – 31.10.2018, në analizën financiare të prindërve. Komisioni ka konsideruar të ardhurat e kumatës së subjektit, në ekonominë familjare, deri në fund të vitit 2013 (kur ajo ka lidhur martesë), në shumën totale 1,025,210 lekë.
30. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur, ndër të tjera, se vjehrra e saj ka përfutur shuma monetare të dërguara nga Kanadaja nga vëllai i saj. Subjekti, së bashku me përgjigjet e pyetësorit, ka paraqitur një deklaratë të lëshuar në datën 31.5.2021 nga shtetasi F. A., i cili ka deklaruar se duke filluar nga viti 2007 – 2016, i ka dërguar motrës së tij, L. Gj., rreth 6,000 CAD çdo vit, vetë apo nëpërmjet familjarëve të tij, kur kanë ardhur në Shqipëri. Si burim për shumën e dërguara kanë shërbyer të ardhurat nga puna e tij në shtetin ku jeton. Për të vërtetuar sa më sipër, subjekti ka paraqitur një vërtetim të datës 10.2.2021 nga shoqëria “A.”, sipas së cilës shtetasi F. A. ka qenë i punësuar në këtë shoqëri prej 29.10.2001 – 16.3.2020 dhe paga e tij vjetore ka qenë 58,153.49 CAD.
31. Lidhur me këtë burim, referuar dhe jurisprudencës së Kolegjit, i cili shprehet se: “... me qëllim që remitancat të vlerësohen në gjykimet pranë Kolegjit, nevojitet që ato të provohen se janë dërgesa vlerash monetare të emigrantëve shqiptarë në vendin e origjinës, të cilat janë realizuar nga burime të ligjshme dhe për të cilat janë përmbushur detyrimet përkatëse tatimore në vendin e krijimit...”, ndërkohë që nuk është provuar as dërgimi i vlerave monetare i emigrantëve në vendin e origjinës dhe as përmbushja e detyrimeve tatimore për të ardhurat e krijuara. Për rrjedhojë, këto shuma nuk janë përfshirë në analizën financiare të prindërve të bashkëshortit të subjektit.
32. Pas përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës së familjes së prindërve të bashkëshortit të subjektit, ka rezultuar se për të kryer depozitimet në llogarinë e tyre të përbashkët në BKT në vitin 2007, të cilat më pas janë dhuruar/transferuar në favor të djalit të tyre në vitin 2014, ka rezultuar se kanë pasur pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 1,440,411 lekë, për të cilën i është kaluar subjektit barra e provës.

Lidhur me pagesën e shumës 10,000 euro nga “Raiffeisen Bank”

33. Nga analiza e lëvizjeve në llogaritë bankare ka rezultuar se shuma 8,000 euro është transferuar nga nëna e bashkëshortit të subjektit në datën 5.11.2012, në llogarinë e këtij të fundit. Kjo shumë ishte krijuar më herët si rezultat i depozitimeve *cash* në llogarinë e saj përkatësisht të shumave:
- shumën 2,000 euro në datën 2.9.2010;
 - shumën 4,000 euro në datën 19.9.2012; si dhe
 - shumën 2,000 euro në datën 5.11.2012, ditë në të cilën është kryer dhe transferimi i shumës totale të disponuar në këtë llogari, në favor të bashkëshortit të subjektit.
34. Po ashtu, Komisioni ka përlllogaritur të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 2009²² – 2012, për dhurimin e kryer nga prindërit e bashkëshortit të subjektit, në favor të këtij të fundit në vitin 2012, të shumave 8,000 euro dhe 6,000 USD, nga të cilat shuma e parë është përdorur për blerjen e apartamentit në analizë, ndërsa shuma e dytë vazhdon të mbetet gjendje në llogari të bashkëshortit të subjektit.
35. Nga sa më sipër, bazuar në të dhënat e disponuara, deri në mbylljen e hetimit administrativ, ka rezultuar se të ardhurat e prindërve të bashkëshortit të subjektit gjatë kësaj periudhe kanë qenë në shumën 1,279,947 lekë, ndërkohë që shpenzimet e jetesës kanë qenë në shumën 1,652,652 lekë, dukshëm më të larta se të ardhurat e dokumentuara. Për rrjedhojë, duket se ata kanë pasur një pamjaftueshmëri totale të burimeve të ligjshme në shumën 1,117,760 Lekë, për depozitimin e shumës 8,000 euro, për të cilën i është kaluar subjektit barra e provës.
36. Përveç shumës prej 8,000 euro të transferuar nga prindërit e tij, bashkëshorti i subjektit ka kryer një depozitim *cash* në datën 13.11.2013, në llogarinë në “Raiffeisen Bank”, të shumës 2,500 euro, me anë të së cilës u plotësua shuma prej 10,000 euro, e tërhequr më pas në vitin 2014, për pagesën e këstit të parë të blerjes së pasurisë në analizë. Sa i përket burimit të ligjshëm, në DIPP-në e vitit 2013, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar shtesën në llogaritë/depozitat e tij me të ardhurat nga pagat dhe nga interesat bankare. Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë deklaruar kursime të disponuara *cash* në banesë, për rrjedhojë, Komisioni ka analizuar mundësitë për kryerjen e këtij depozitimi me burime të ligjshme financiare, me të ardhurat nga pagat e vitit 2013.
37. Nga analizimi i llogarive bankare, duket se paga e bashkëshortit të subjektit gjatë asaj periudhe, nuk është kaluar nëpërmjet bankës nga punëdhënësi. Për rrjedhojë, Komisioni mori në konsideratë pagat e tij, referuar të dhënave të dërguara nga ISSH-ja, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 25.2.2020, sipas së cilës deri në qershor të vitit 2013, paga e *bruto* ka qenë në shumën 23,100 lekë/muaj dhe nga korriku i vitit 2013, paga *bruto* ka qenë 50,000 lekë/muaj. Subjekti ka paraqitur, gjithashtu, një vërtetim të lëshuar nga punëdhënësi i bashkëshortit shoqëria “D.” sh.p.k., ku citohet se bashkëshorti ka përfituar përgjatë periudhës 2009 – 2013, të ardhura në formën e shpërblimit të performancës, në bazë të xhiros së realizuar prej tij. Ndërkohë, nga dokumentacioni i administruar nuk ka rezultuar

²²Analiza është kryer duke filluar nga viti 2009, pasi në vitin 2008, prindërit e bashkëshortit të subjektit i kanë dhuruar këtij të fundit, shumën 600,000 Lekë, të deklaruar si burim për blerjen e automjetit, të trajtuar në pikën 3 të këtij relacioni.

ndonjë pagesë kontributesh për ndonjë shumë tjetër, përveç pagave mujore. Për rrjedhojë, këto të ardhura nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nuk janë përfshirë, në analizën financiare.

38. Pas përfshirjes në analizë edhe të shpenzimeve, është konkluduar se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, për kryerjen e depozitimit në fjalë në shumën 134,883 lekë.

Lidhur me pagesën e shumës 600,000 lekë nga “Alpha Bank”

39. Nga shqyrtimi dhe analizimi i lëvizjeve në llogaritë bankare, ka rezultuar se shuma në fjalë është krijuar nëpërmjet depozitimeve *cash* të kryera nga bashkëshorti i subjektit gjatë vitit 2012 në shumën totale 574,000 lekë dhe derdhje nga persona të tretë në vitin 2013 në shumën 125,000 lekë²³.
40. Në vijim të analizës së kryer vetëm mbi të dhënat e disponuara përgjatë hetimit administrativ, duke qenë se subjekti dhe bashkëshorti kanë rezultuar me pamjaftueshmëri për të kryer depozitimet deri në vitin 2012 në llogarinë e këtij të fundit në “Raiffeisen Bank”, për rrjedhojë, edhe për këto depozitime është konstatuar një pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme në vlerën 574,000 lekë.
41. Lidhur me depozitim të kryer nga shtetasi O. A., në shumën 100,000 lekë, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime nëpërmjet pyetësorit nr. 2. Në përgjigje të tij, subjekti ka sqaruar se depozitimi është kryer pasi ky i fundit në vitin 2010 kishte marrë disa materiale në dyqanin e babait të bashkëshortit dhe nuk i kishte paguar në momentin e marrjes. Për të provuar sa më sipër, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 26.5.2021, nga shtetasi O. A.²⁴.

Lidhur me huamarrjen në shumën 1,680,000 lekë

42. Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një hua, në vlerën 1,680,000 lekë, të marrë nga shtetasi V. Ç.²⁵. Për këtë hua ka rezultuar e deklaruar edhe shlyerja në DIPP-të në vitet në vijim.
43. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar huan të mbetur në vlerën 1,127,000 lekë, ende të palikuiduar, si dhe ka deklaruar si burim për kthimin e pjesshëm të huas të ardhurat nga paga e saj dhe të bashkëshortit.
44. Në mbështetje të deklarimeve të lart përshkruara, subjekti ka depozituar në cilësinë e provës deklaratën noteriale nr. ***, datë 26.2.2020, në të cilën shtetasi V. Ç. ka deklaruar se shuma e palikuiduar prej 1,680,000 lekësh për blerjen e apartamentit është konsideruar hua, e cila do të likuidohet gradualisht deri në momentin e pajisjes së blerësit me certifikatë pronësie²⁶.
45. Referuar deklarimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni

²³Derdhje nga shtetasja L. Xh. në shumën 25,000 lekë me përshkrim “për pagesë telefoni” dhe një derdhje në shumën 100,000 lekë nga shtetasi O. A..

²⁴Subjekti ka paraqitur, gjithashtu, diplomën e shtetasit O. A. nga universiteti “Aleksandër Xhuvani” dhe ka bërë me dije se kanë qenë shokë klase me bashkëshortin në vitin 2010, kur ka blerë materialet në dyqanin e vjehrrit të subjektit.

²⁵Deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.2.2020, e bërë nga deklaruesi V. Ç.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.7.2015, me deklarues V. Ç. dhe Q. Gj..

²⁶Kjo klauzolë ka qenë e parashikuar edhe në kontratën fillestare të nënshkruar mes palëve.

përgjatë hetimit administrativ, kjo shumë është likuiduar si vijon:

- në vitin 2016, janë shlyer shumat 2,000 euro dhe 273,000 lekë;
- në vitin 2017, janë shlyer shumat 265,000 lekë dhe 264,400 lekë;
- në vitin 2018, është shlyer shuma 128,000 lekë;
- në vitin 2021, është shlyer shuma 469,600 lekë.

46. Nga analiza e lëvizjeve në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit ka rezultuar se shumat e shlyera në datat 28.9.2016 dhe 2.2.2017, përkatësisht 273,000 lekë dhe 265,000 lekë, nga llogaria në BKT, kanë pasur si burim të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të subjektit nga shoqëria "D." sh.p.k., të patërhequra prej tij dhe një depozitim/dhurim nga babai i tij në shumën 150,000 lekë. Ndërkohë që në vitin 2016, prindërit kanë pasur mundësi për dhurimin e kësaj shume, pasi të ardhurat e realizuara prej tyre gjatë këtij viti kanë qenë në shumën totale 1,483,525 lekë. Ndërsa, shuma prej 2,000 euro, e shlyer nëpërmjet një depozitimi *cash* në llogarinë e shtetasit V. Ç., në datën 1.2.2016, është deklaruar prej subjektit në deklaratën *Vetting*, me burim nga kursimet *cash* të deklaruara në DIPP-në e vitit 2015. Referuar analizës financiare, në vitin 2015, subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi për të realizuar kursimet *cash* në shumën 600,000 lekë, të cilat kanë qenë të mjaftueshme për kryerjen e pagesës në fjalë, me burime të ligjshme financiare.
47. Ndërsa shuma prej 264,400 lekësh ka rezultuar e shlyer nga llogaria e bashkëshortit në BKT, në datën 5.7.2017, me burim nga pagat e tij dhe nga një transfertë e subjektit në vlerën 130,000 lekë, e transferuar nga llogaria e saj e pagës. Edhe shuma prej 128,000 lekësh në datën 8.5.2018, rezulton të jetë krijuar me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga paga dhe nga një transferim nga llogaria e pagës së subjektit në shumën 130,000 lekë. Lidhur me pagesën e fundit në shumën 469,600 lekë të kryer në prill të vitit 2021, Komisioni, në mungesë të DIPP-ve të viteve 2019 dhe 2020, mbi kursime të mundshme në *cash* dhe të llogarisë bankare të bashkëshortit për këtë periudhë, është në pamundësi objektive për të përcaktuar ligjshmërinë e burimeve të përdorura për kryerjen e kësaj pagese.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

48. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë së llojit apartament banimi me sipërfaqe 108,6 m², me vendndodhje në S., Tiranë, ka parashtruar sa vijon:
49. Lidhur me pagesën në shumën 5,000,000 lekë të kryer nga "Raiffeisen Bank", për të cilën Komisioni ka konstatuar pamjaftueshmëri financiare në vlerën 1,786,000 lekë, subjekti ka specifikuar se: "[...] Për krijimin e kursimeve në masën 2,000,000 lekë, të përdorura për blerjen e pasurisë apartament banimi, kanë shërbyer kursimet e bashkëshortit nga punësimi, ndër vite, përpara se unë të filloja detyrën, të cilat kanë qenë të depozituara në llogarinë e tij në 'Raiffeisen Bank', të hapur në vitin 2006. Në kohën kur jam emëruar në detyrë, gjendja në llogarinë e bashkëshortit ka qenë në vlerën 1,695,165 lekë dhe janë përfituar nga punësimi i tij pranë personit fizik "J. Z.". Për rrjedhojë, këto të ardhura duhet të llogariten si të ardhura nga burime të ligjshme të personit të lidhur. Pas kësaj periudhe, nga viti 2008 – 2012, bashkëshorti ka përfituar pagë në shumën 1,067,093 lekë si i punësuar pranë shoqërisë 'D.' sh.p.k., si dhe të ardhura në formën e shpërblimit të

performancës, në bazë të xhiros së realizuar prej tij, të cilat i ka deklaruar si në deklarinimin para fillimit të detyrës, ashtu edhe në DPV-të e vitit 2012 dhe të vitit 2013 se është i punësuar pranë 'D.' sh.p.k., ku paguhet me pagë fikse + 2% të xhiros vjetore të realizuar prej tij, për të cilat është paguar tatim në burim.

50. Në deklaratën para fillimit të detyrës të bërë nga bashkëshorti, në faqen 11 të saj, ai ka deklaruar se ka punuar në biznesin e babait, 'Rr. R.', Elbasan, shuma e të ardhurave 500.000 Lekë dhe, po kështu, i ka deklaruar ato edhe në deklaratën Vetting. Provë është ekstrakti i llogarisë bankare të bashkëshortit ku edhe janë depozituar këto të ardhura përgjatë viteve 2006 – 2009. Provë është gjithashtu edhe shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore nga ku rezulton se që prej vitit 2000 e në vijim babait i bashkëshortit ushtron veprimtari tregtare. Bëhet fjalë për një shumë që prej vitit 2000 deri në vitin 2009 ka arritur vlerën 500.000 lekë, pra, rreth 55.000 – 56.000 lekë/vit dhe duke qenë se janë pjesë e të ardhurave të krijuara nga aktiviteti tregtar i babait të bashkëshortit, të deklaruara në organet kompetente dhe për të cilat janë paguar detyrimet prej vjehrrit, nuk mund të taten dy herë.
51. Gjithashtu, duhet të merren në konsideratë të ardhurat e mia për periudhën 2006 – 2012, nga bursa nga Shkolla e Magjistraturës, paga nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe 66,550 lekë nga punëdhënësi 'A. M. S.' në vitin 2010, pra, në total 1,292,440 lekë.
52. Në lidhje me depozitën e kryer nga prindërit e bashkëshortit në llogarinë bankare të tij, sqarohet se shuma prej 3,000,000 lekësh është depozituar prej prindërve të bashkëshortit në llogarinë e tyre të përbashkët në BKT në vitin 2007 dhe ka pasur si burim kursimet dhe aktivitetin e prindërve të bashkëshortit në vite. Referuar të dhënave zyrtare të publikuara nga INSTAT, rezulton se para vitit 2009 në sektorin e ndërtimit, shitjet kanë qenë shumë të larta krahasuar me pas këtij viti kur kanë pësuar një rënie drastike, çka tregon tendencën e tregut në atë kohë në këtë sektor. Ky rezultat i nxjerrë nga INSTAT përputhet me situatën faktike nga viti 2008 e në vijim, kur fitimi ka qenë më i ulët se sa përpara këtij viti. Për rrjedhojë, minimalisht në përlllogaritje duhet të merret i barabartë me fitimin e vitit 2008 pra në masën 32%. Vetëm me këtë ndryshim, mbulohet totalisht diferenca negative e konstatuar.
53. Duke qenë se për një pjesë të viteve gjatë të cilëve kanë ushtruar aktivitet, prindërit e bashkëshortit kanë deklaruar në organet përkatëse xhiron (të ardhurat) dhe jo fitimin, pasi ligji në fuqi këtë parashikonte për biznesin e vogël, paraqes si provë një aktekspertimi i kryer nga një audituese ligjore, nga ku evidentohet se të ardhurat nga paga e vjehrrit janë llogaritur si shpenzim në të ardhurat e personit fizik (në bilancin tregtar të aktivitetit që ai ushtron).
54. Lidhur me burimin e të ardhurave të dërguara nga shtetasi F. A. për nënën e bashkëshortit, sqarohet se ky shtetas nuk është person i lidhur në kuptim të ligjit dhe marrëdhënien e ka me motrën e tij, pasi asaj ia ka dërguar këto të ardhura të cilat më janë bërë me dije, në kuadër të kthimit të përgjigjeve në pyetësorin nr. 2. Ky shtetas ka jetuar dhe punuar nga viti 2000 dhe deri aktualisht në shtetin kanadez. Shoqëria 'A.', pranë së cilës ka qenë i punësuar për rreth 19 vjet, është një nga shoqëritë më të mëdha farmaceutike në të gjithë botën dhe nuk ndodh që të mos paguar detyrimet tatimore”.

55. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës, dokumentacionin si vijon:
- vërtetim nënshkrimi për deklarin e shtetaseve A. A. dhe A. K., për dërgimin/dorëzimin e parave në favor të vjehrrës së subjektit, si dhe e-mail i shtetasit F. A. së bashku me deklaratën vjetore të të ardhurave të vitit 2016;
 - deklaratë noteriale nr. ***, datë 27.7.2021, të shtetasit Th. K.;
 - bilance të viteve 2008 – 2014 të aktivitetit “I. Gj.” Person Fizik, sipas së cilave pagat janë përlogaritur si shpenzim për vitet 2008, 2009, 2010, 2012, 2013 dhe 2014;
 - vërtetim nr. *** prot., datë 23.7.2021, nga Bashkia Elbasan, që vërteton se “I. Gj.” person fizik ka paguar detyrimet për taksat dhe tarifatat e biznesit të vogël, për vitet 2006 – 2012;
 - shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.7.2021, nga DPT-ja për kërkesën e bërë nga subjekti për interpretim, lidhur me detyrimet për biznesin e vogël.
56. Në lidhje me pagesën në shumën prej 600,000 lekësh nga “Alpha Bank”, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës bilancin e shoqërisë “D.” sh.p.k., të vitit 2013, si dhe ka sqaruar se: *“... shuma në fjalë është krijuar nëpërmjet depozitimeve cash të kryera nga bashkëshorti në llogarinë personale e tij gjatë vitit 2012, në vlerën totale 574,000 lekë dhe derdhe nga persona të tretë në vitin 2013 në vlerën 125,000 lekë, përpara se unë të filloja praktikën si gjyqtare stazhiere më 10.10.2012. Pas kësaj date në llogarinë e tij është depozituar prej tij vetëm shuma 105,000 lekë. Nga viti 2009 deri në vitin 2013, bashkëshorti ka përfutuar pagesë prej 2 % të xhiros vjetore të realizuar prej tij. Nga 600.000 lekë të kaluara për blerjen e apartamentit, është provuar burimi i ligjshëm për shumën 100.000 lekë, ndaj maksimumi i diferencës negative, edhe sikur bashkëshorti të mos justifikojë asnjë pjesë tjetër, do ishte 500.000 lekë dhe jo 574.000 lekë”.*
57. Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme financiare në vlerën 134,883 lekë, për krijimin e kursimeve në shumën 2,500 euro, të përdorura më pas për blerjen e pasurisë në analizë, subjekti është shprehur: *“Kërkoj të rishikohen shpenzimet e vitit 2013, konkretisht duke ulur shpenzimet e udhëtimeve, për udhëtimet që bashkëshorti ka kryer për arsye pune, kostot e të cilave janë mbuluar nga punëdhënësi, si dhe uljen e shpenzimeve të udhëtimit për dy udhëtime turistike, në Korfuz dhe në Dubrovnik, konkretisht në 635 euro për të dy udhëtimet, në krahasim me 1,075 euro, të llogaritura nga Komisioni”.*
58. Gjithashtu, subjekti, lidhur me sa më sipër, ka paraqitur në cilësinë e provës:
- vërtetim nga shoqëria “D.” sh.p.k., për udhëtimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit, me qëllim pune dhe për të cilat janë mbuluar shpenzimet;
 - fatura të hoteleve për qëndrimin në Korfuz dhe në Dubrovnik.

Vlerësimi i trupit gjykues

59. Lidhur me pamjaftueshmërinë financiare në vlerën 1,786,000 lekë, të konstatuar nga Komisioni në lidhje me pagesën prej 5,000,000 lekësh, për të cilën subjekti ka pretenduar se bashkëshorti ka pasur gjendje në llogarinë e tij bankare, si kursime që arrinin në vlerën 2,000,000 lekë, përpara emërimit të saj në detyrë dhe, për rrjedhojë, duhet të konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm, thjesht për faktin se ato shuma janë krijuar dhe kursyer

përpara se të niste funksioni i saj si gjyqtare, trupi gjykues vlerëson se – përpos faktit se kjo rrethanë duhet të mbahet parasysh në vlerësimin final mbi kriteret e aplikimit ose jo të ndonjë mase, duke e çmuar rastin nën dritën e parimeve të proporcionalitetit dhe të objektivitetit – ky pretendim gjendet i pabazuar dhe bie ndesh me objektin e procesit të rivlerësimit.

60. Referuar ligjit nr. 84/2016, rezulton se objekti i vlerësimit të pasurisë është pikërisht kontrolli i pasurisë, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre dhe i përmbushjes së detyrimeve financiare (me burime të ligjshme) – pa u parashikuar ndonjë kufizim kohor lidhur me momentin e krijimit të burimeve – dhe të vërtetësisë së deklarimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe nga personat e lidhur me të, si dhe është përcaktuar qartë përkufizimi i të ardhurave të ligjshme. Në pikën 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, është përcaktuar: *“Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin mbi tatimin mbi të ardhurat*”. Në këtë këndvështrim, për sa i përket pretendimit të subjektit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortit të saj në vlerën 690,000 lekë, të përfituara nga punësimi i tij pranë personit fizik “J. Z.”, ky pretendim mbetet vetëm në nivel deklarativ dhe nuk ka asnjë provë apo dokumentacion të kohës apo aktual në mbështetje të tij. Deklarimi i këtyre të ardhurave në deklaratën përpara fillimit të detyrës nuk përbën provë të përfitimit dhe as nuk provon burimin e ligjshëm të tyre. Ndonëse ato mund të jenë përfiturar *de facto*, nga ISSH-ja i është bërë me dije Komisionit se kontributet për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe TAP, janë paguar vetëm për shumën totale *neto* prej 177,726 lekësh dhe jo për të gjithë shumën e pretenduar nga subjekti. Për rrjedhojë, Komisioni nuk mund të shkojë përtej kësaj shifre duke marrë parasysh burimet e ligjshme të këtij zëri të të ardhurave të pretenduara.
61. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizë të të ardhurave të bashkëshortit të përfituara nga punësimi pranë shoqërisë “D.” sh.p.k., për periudhën 2008 – 2012, në vlerën 1,067,093 lekë, si dhe të ardhurat e përfituara nga shpërblimi mbi xhiron e realizuar prej tij në masën 2% në vit, evidentohet se pas mbylljes së hetimit administrativ, Komisioni ka administruar dokumentacionin nga ISSH-ja Durrës²⁷, nga ku rezultoi se për pagën e bashkëshortit përgjatë kësaj periudhe, janë paguar kontributet dhe detyrimet përkatëse. Bazuar në sa më sipër u rillogaritën të ardhurat për periudhën e sipërcituar, në total në vlerën 1,086,286 lekë, të cilat më pas u përfshinë në analizën financiare.
62. Ndërsa, për sa i përket të ardhurave të pretenduara si të përfituara nga bashkëshorti në formën e shpërblimit prej 2%, mbi xhiron e realizuar prej tij, vërehet se bazuar në parashikimet e nenit 109, të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, ku me pagë kuptohet *“paga bazë si dhe shtesat me karakter të përhershëm”* dhe referuar VKM-së nr. 1114, datë 30.7.2008, ku përcaktohet se: *“Paga bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve, është paga e caktuar sipas legjisllacionit në fuqi ose në kontratën e punës dhe shtesat e tjera, me karakter të përhershëm, që lindin nga marrëdhëniet e punës. Në pagën bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve, nuk përfshihen: (a) përfitimet në mënyrë të përhershme nga fondet e sigurimeve shoqërore; (b) kompensimet nga rritja e çmimeve; (c)*

²⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 23.8.2021, nga ISSH-ja Drejtoria Rajonale Durrës.

dhuratat në të holla, që nuk kanë karakter të përhershëm dhe të përgjithshëm;(ç) të ardhurat nga detyrimi ushqimor, të caktuara me vendim gjykate;(d) vlera e antidoteve, që punëdhënësi jep në natyrë, sipas legjislacionit në fuqi; (dh) shpërblimet me karakter jo të përhershëm, të lejuara në mbështetje të legjislacionit në fuqi, shpërblimet nga fondi i veçantë, për rastet e fatkeqësive në familje, për sëmundje të gjata, për dëme, në raste fatkeqësish të mëdha natyrore, e për veprimtari të shquara; (e) vlera e shpenzimeve, për të punësuarit, që kryejnë veprimtari jashtë qendrës së banimit; (ë) honoraret apo shpërblimet e tjera, të kësaj natyre, që nuk kanë lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës”.

63. Referuar dispozitës së sipërcituar, ku evidentohet qartazi se cilat janë shtesat që nuk përfshihen në pagën *bruto* dhe mbi të cilën nuk paguhen kontributet e detyrueshme, vlerësohet se shpërblimi mbi performancën i përfituar nga bashkëshorti i subjektit ka qenë i karakterit të përhershëm dhe, për rrjedhojë, punëdhënësi ka pasur detyrimin ta përfshinte këtë shpërblim në pagën *bruto*, si dhe të paguante kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe TAP. Nga dokumentacioni i administruar pas mbylljes së hetimeve, nga DRT-ja Durrës²⁸, ka rezultuar se përgjatë periudhës 2009 – 2014, shoqëria “D.” sh.p.k., ka paguar tatim në burim vetëm për qiratë dhe për dividendët e shpërndarë, por nuk ka rezultuar ndonjë pagesë e kryer lidhur me shpërblime të mundshme të dhëna personelit.
64. Gjithashtu, ka rezultuar se pas fillimit të detyrës nga subjektit, nga muaji qershor i vitit 2013 dhe në vijim, bashkëshorti i saj ka filluar të sigurohet nga punëdhënësi për një pagë më të lartë (rreth dyfishi) dhe nuk ka deklaruar më ndonjë përfitim në formën e shpërblimeve mbi performancën. Kjo rrethanë nënkupton se përfitimet e pretenduara, si më lart, nga vet palët, janë vlerësuar si jo të ligjshme për sa kohë është ndryshuar mënyra e marrjes së tyre nga bashkëshorti i subjektit.
65. Nisur nga sa më lart, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit me këtë zë të ardhurash shtesë, mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mund të konsiderohen si burime të ligjshme në kuptimin e nenit “D”, të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë nuk ka rezultuar që të jenë provuar, kriteret thelbësore të parashikuara për këtë qëllim, si vijon:
- i. kalimi i tyre fiziko-faktik në favor të bashkëshortit i subjektit, pasi ndryshe nga paga mujore bazë shumë e pretenduara si shpërblim nuk janë kaluar nëpërmjet sistemit bankar, dhe deklarata e punëdhënësit përgjatë hetimit administrativ, nuk përbën provë bindëse, në mungesë të provueshmërisë së rrethanave të tjera mbështetëse;
 - ii. përmbushja e detyrimeve tatimore, lidhur me shumë e pretenduara si të përfituara në formën e shpërblimit, jo vetëm që nuk është provuar, por përkundrazi, nga analizimi i përmbajtjes së dokumentacionit të administruar nga Komisioni, arrihet në konkluzionin se duhet të përjashtohet kjo mundësi;
 - iii. mungesa e dijenisë nga pala përfituese e të ardhurave të pretenduara, lidhur me mospagesën e detyrimeve tatimore nga punëdhënësi, në raport me pagesat shtesë, si shpërblim, nuk rezulton të jetë provuar. Madje, nisur nga fakti që, sipas pretendimeve të subjektit, përfitimi i shumëve përkatëse ka ndodhur pjesërisht

²⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 17.8.2021, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës.

nëpërmjet transfertave bankare (të pagës bazë), dhe pjesa tjetër është marrë *cash* në dorë, në kombinim me rrethanat e tjera dhe me dinamikën modifikuese – si më sipër – krijohet bindja se përfituesi i shumave si shpërblim nuk mund të mos kishte dijeni se për to nuk paguheshin detyrimet tatimore, përndryshe përse ato nuk kalonin nëpërmjet sistemit bankar, sikurse ndodhte për pagën bazë.

66. Lidhur me pretendimin e subjektit se detyrimi për deklarimin dhe kryerjen e pagesave për kontributet e detyrueshme i takojnë punëdhënësit, trupi gjykues vëren veç sa është arsyetuar në pikën pararendëse, në mbështetje të këtij vlerësimi duhet mbajtur në vëmendje edhe jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, konkretisht, sa është shprehur në pikat 24.4 dhe 24.17, të vendimit nr. 23/2020 (JR), datë 25.9.2020, ku citohet se: “... Kolegji vëren se gjendet i drejtë gjithashtu pretendimi i Komisionerit Publik, se duhet të konsiderohen burime të ligjshme vetëm ato për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, përkundër shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, se [...] i takon punëdhënësit të zbresë nga paga dhe të paguajë në organet përgjegjëse tatimin mbi të ardhurat dhe kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, dhe nuk është përgjegjësi e punëmarrësit mospërbushja e këtij detyrimi [...], pasi ky shpjegim nuk ndikon në një interpretim të ndryshëm të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nga sa është interpretuar tashmë gjyqësish dhe ka gjetur pasqyrim në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, mbi ligjshmërinë e të ardhurave dhe detyrimin kushtetues të përmbushjes së detyrimeve përkatëse tatimore...”.
67. Sa i përket shumës 500,000 lekë, të pretenduar nga bashkëshorti i subjektit, si të përfituar si kompensim të punës/ndihmës së dhënë prej tij në dyqanin e babait, trupi gjykues vlerëson se kjo rrethanë mbetet në nivel deklarativ dhe nuk përmbush asnjë nga kriteret (e lartpërmendur) dhe as ata për t’u kualifikuar si një marrëdhënie punësimi, duke qenë se bashkëshorti i subjektit nuk është deklaruar prej Personit Fizik si i punësuar dhe nuk janë paguar detyrimet përkatëse që lindin nga një marrëdhënie e mirëfilltë punësimi. Gjithashtu, deklarimi i kësaj shume apo punësimi të pretenduar prej bashkëshortit në deklaratat periodike dhe ekzistenca e aktivitetit nuk përbëjnë provë për përfitimin e shumës 500,000 lekë dhe as të ligjshmërisë së tyre. Ndonëse deklarimet vjetore mund të përbejnë provë, ato në vetvete nuk mjaftojnë, por duhet të mbështeten dhe të shoqërohen me rrethana dhe prova të tjera, për të çuar në vlerësimin final të ekzistencës (së mundshme) të një burimi financiar të ligjshëm, të gjeneruar nga pretenduesi/deklaruesi, gjë që nuk është konstatuar në këtë rast. Fakti se Personi Fizik ka paguar detyrimet tatimore për biznesin e vet, përmbush vetëm kërkesat ligjore në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë tregtare nga një shoqëri tregtare, por transferimi më pas i fitimit në favor të bashkëshortit të subjektit, në një mënyrë të ligjshme, qoftë punësimi apo ortakërie në biznes, do të kërkonte detyrimisht pagimin e detyrimeve tatimore përkatëse, për t’u kualifikuar si burim i ligjshëm i këtyre të ardhurave.
68. Për sa i përket të ardhurave të realizuara nga subjekti për periudhën 2006 – 2012, në rezultatet e hetimit, ato gjenden pjesërisht të bazuara dhe janë vlerësuar e ripërllogaritur duke kaluar nga vlera prej 640,050 lekësh në vlerën 1,031,050, të ardhura nga bursa e Shkollës së Magjistraturës. Në këtë shumë nuk janë përfshirë të ardhurat nga paga e subjektit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vitin 2012, pasi shuma e analizuar është

depozituar në llogarinë bankare të bashkëshortit, përpara fillimit të detyrës prej subjektit. Është shtuar në analizë edhe shuma 66,550 lekë, nga të ardhurat nga punësimi në vitin 2010, në shoqërinë “A. M. S.” sh.p.k., për të cilat ndonëse nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion që të provojë marrëdhënien e punësimit apo të pagimit të detyrimeve tatimore nga shoqëria punëdhënëse, ato janë transferuar nëpërmjet “Intesa Sanpaolo Bank”, në llogarinë e subjektit, me përshkrimin “të ardhura nga paga”. Në konkluzion, trupi gjykues çmoi të pranojë si të provuar për llogari të këtij procesi shumë e pretenduar prej 1,097,550 lekësh. Megjithatë, vërehet se edhe pas përfshirjes në analizë të këtyre shumave monetare shtesë, balanca negative e analizës financiare që ishte përcjellë me rezultatin e hetimeve, ndonëse pakësohet, nuk shuhet.

Tabela nr. 2 – Analiza e burimeve në rezultate dhe pas prapësimeve

	Pas prapësimeve	Ne rezultate
Të ardhura nga paga b/shortit 2006-2012	1 264 012	1 099 460
Dhuratë nga babai	-	-
Të ardhura nga bursa e subjektit	1 031 050	640 050
Të ardhura nga punësimi i subjektit	66 500	-
Depozituar 2006 - 2012	- 1 786 000	- 1 786 000
Shpenzime jetese 2006 - 2012	- 2 760 449	- 2 760 449
Rezultati	- 2 184 886	- 2 806 938

69. Në përfundim të sa më sipër, ndonëse balanca e mësipërme, nuk justifikon me burime të ligjshme financiare në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të gjitha depozitimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit në llogarinë e tij bankare përgjatë periudhës 2006 – 2012, për sa kohë: (i) këto shuma rrjedhin nga marrëdhënie punësimi të bashkëshortit të subjektit, ndër vite, për të cilat, ndonëse me qëllim përfitimi prej njëres apo të dyja palëve, nuk janë zbatuar të gjitha kërkesat ligjore për deklarimin e tyre të saktë e të plotë në organet përkatëse tatimore; si dhe (ii) depozitimet në fjalë janë kryer në mënyrë të herëpashershme, përpara fillimit të detyrës së subjektit, trupi gjykues çmon se kjo mungesë nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi dhe/apo të passjellë marrjen e ndonjë mase ndaj subjektit të rivlerësimit.
70. Në lidhje me dhurimin në shumën 3,000,000 lekë, nga prindërit e bashkëshortit, të përdorura më pas për blerjen e pasurisë në analizë, për të cilën Komisioni ka konstatuar me mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1,440,411 lekë, subjekti së bashku me prapësimet ka paraqitur vërtetimet e lëshuara nga Bashkia Elbasan²⁹ dhe DRT-ja Elbasan³⁰, të cilat konfirmojnë pagimin e taksave dhe tarifave vendore të biznesit të vogël. Referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, konkretisht në Kreun III, neni 10, pika 3, përcaktohet: “Çdo subjekt i cili kryen një biznes me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 8,000,000 Lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël”. Gjithashtu, pikën 4, të nenit 11, të ligjit të sipërcituar është përcaktuar: “Niveli tregues i taksës për çdo kategori biznesi, në varësi të qarkullimit vjetor, të ndarë sipas intervaleve prej 1.000.000 lekësh, duke filluar nga vlera minimale prej 2.000.000 lekësh, jepen në

²⁹Vërtetim nr. *** prot., datë 23.7.2021.

³⁰Shkresë nr. *** prot., datë 21.7.2021.

aneksin nr. 5, që i bashkëlidhet këtij ligji”. Nga shqyrtimi i dispozitës së sipërcituar, rezulton se për bizneset me aktivitet shitje me pakicë dhe shitje me shumicë (sikurse në rastin e prindërve të bashkëshortit të subjektit), niveli tregues i taksës i kategorisë nr. 2 (ku përfshihet dhe qyteti i Elbasanit në të cilin ka selinë shoqëria tregtare), përputhen me taksën e biznesit të vogël të paguar, konkretisht, nga prindërit e bashkëshortit të subjektit në vitet përkatëse. Për rrjedhojë, nisur nga vlerësimi harmonik i të dhënave të lartpërmendura, arrihet në konkluzionin se këto aktivitete kanë përmbushur detyrimet përkatëse tatimore, referuar legjislacionit në fuqi dhe të ardhurat e rezultuara duhet të konsiderohen me burim të ligjshëm, ndonëse për disa vite specifike, përgjatë hetimit administrativ, këto të ardhura nuk ishin marrë në konsideratë, për sa kohë ende nuk ishte administruar vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Elbasan, i sipërcituar.

71. Nisur nga fakti që dokumentacioni i paraqitur prej subjektit provon që aktivitetet e prindërve të bashkëshortit të saj kanë paguar një detyrim tatimor që i përket një xhiro të caktuar, të parashikuar dhe të vetëdeklaruar nga bizneset, konstatohet se mbetet e paqartë se sa ka qenë realisht dhe saktësisht xhiroja e realizuar në vitet 2000 - 2007 dhe 2012, për aktivitetin e vjehrrit dhe për vitet 2008 – 2013 për aktivitetin e vjehrrës së subjektit. Në mungesë të këtyre të dhënave dhe duke u nisur nga xhirot e vetëdeklaruar, Komisioni ka përllogaritur dhe shtuar në analizën financiare të prindërve të bashkëshortit të subjektit, të njëjtin marzh fitimi (mesatar) të rezultuar në vitet 2008 – 2016 për aktivitetin e babait dhe për vitet 2014 – 2016 për aktivitetin e nënës, i cili është aplikuar edhe në vitet për të cilat mungon e dhëna konkrete mbi fitimin e realizuar, për sa kohë këto aktivitete kanë paguar detyrimet përkatëse tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Në këto kushte, duke shtuar të ardhurat e viteve 2007 dhe 2012 për aktivitetin e babait me marzhin 23% dhe të ardhurat e aktivitetit të nënës për vitet 2008 – 2013 me marzhin 41%, të ardhurat e prindërve të bashkëshortit do të rezultonin të mjaftueshme për të mundësuar dhurimet e kryera në vitin 2012 të shumave përkatësisht 8,000 euro dhe 6,000 USD dhe pjesërisht të shumës prej 3,000,000 lekë në vitin 2014, sipas detajimeve të tabelave vijuese:

Tabela nr. 3 – Analiza e burimeve të prindërve në rezultate dhe pas prapësimeve

	Pas prapësimeve	Ne rezultate
Të ardhura nga aktiviteti babait 2000-2007	4 888 921	3 712 564
Të ardhura nga aktiviteti nënës 2000-2007	-	-
Të ardhura nga paga B. Gjuzi 2000-2007	-	-
Depozituar në 2007/dhuruar djalit	- 3 000 000	- 3 000 000
Shpenzime jetese 2000-2007	- 2 476 976	- 2 152 976
Rezultati	- 588 054	- 1 440 411

Tabela nr. 4 – Analiza e burimeve të prindërve në rezultate dhe pas prapësimeve

	Pas prapësimeve	Ne rezultate
Të ardhura nga aktiviteti babait 2009-2012	872 585	721 225
Të ardhura nga aktiviteti nënës 2009-2012	2 529 206	-
Të ardhura nga paga I. Gjuzi 2009-2012	509 533	
Të ardhura nga paga B. Gjuzi 2009-2012	558 722	558 722
Depozituar në 2012/dhuruar djalit	- 1 757 180	- 1 117 760
Shpenzime jetese 2009-2012	- 1 652 652	- 1 652 652
Rezultati	1 060 214	- 1 490 465

72. Në përfundim të analizës së mësipërme, duke ndjekur të njëjtën logjikë si në rezultatet e hetimit, për dhurimet e kryera nga prindërit e bashkëshortit të subjektit, do të rezultonte një mungesë e burimeve të ligjshme financiare në shumën 588,054 lekë, për kursimin e shumës 3,000,000 lekë dhe një mjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare për kursimin e shumës 1,757,180 lekë (8,000 euro dhe 6,000 USD).
73. Lidhur me kërkesën e subjektit që të konsiderohet marzhi i fitimit *bruto* në shumën prej 35% ose minimalisht sa ai i vitit 2008, prej 32%, trupi gjykues vlerëson se nisur dhe nga të dhënat e INSTAT “*Mbi indeksin e kushtimit në ndërtim*” (e cila mat ecurinë e çmimeve të materialeve të ndërtimit), ka rezultuar se çmimet e tyre janë rritur në vitin 2000 dhe kanë ardhur në rënie në vitet në vijim, deri në vitin 2009. Sa i përket shitjeve në vitet 2000 – 2007, për të cilat subjekti ka pretenduar se kanë qenë më të larta, kjo mund të vërtetohet pjesërisht nga të dhënat e parashikuara nga vjehëri i subjektit, të cilat për këtë periudhë variojnë nga 2,000,000 lekë – 3,500,000 lekë, ndryshe nga vitet në vijim kur xhiro kryesisht është deklaruar brenda intervalit 1,000,000 – 2,000,000 lekë. Por, kjo nuk nënkupton detyrimisht se përderisa xhiro ka qenë më e lartë edhe marzhi i fitimit në raport të njëjtën njësi matëse të xhiros ka qenë më i lartë, pasi kostot e subjektit si për lëndën e parë ashtu edhe për fuqinë punëtore prezumohet se kanë qenë në raport të drejtë me rritjen ose uljen e vëllimit të punës/xhiros. Për rrjedhojë, çmohet më e ekuilibruar aplikimi i një marzhi fitimi mesatar dhe jo ai i një viti specifik. Megjithatë, vlen të theksohet se edhe nëse do të merrej në konsideratë pretendimi i subjektit dhe do të aplikohet marzhi i fitimit të vitit 2008, në masën 32% të volumit të xhiros, në konkluzionet e analizës financiare, ndonëse burimi i dhurimit nga prindërit në shumën 3,000,000 lekë do të rezultonte tërësisht me burime të ligjshme, do të mbetej sërish një balancë negative. Konkretisht, vlera negative për periudhën 2012 – 2016 do të rezultonte në shumën 480,852 lekë në rastin e aplikimit të marzhit të fitimit prej 32%, ndërkohë që vlera negative do të ishte në shumën 900,050 lekë në rast se do të aplikohet marzhi prej 23% për aktivitetin e babait të bashkëshortit të subjektit. Në këto kushte, trupi gjykues nuk konstaton midis dy rezultateve në fjalë një diferencë domethënëse dhe me një peshë specifike të tillë për të ndryshuar efektet që kjo mungesë burimesh do të passillte, pasi në të dy rastet gjendemi përballë një mungese të mjeteve monetare jo shumë të lartë, që, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit, çmohet në vetvete e pamjaftueshme për të justifikuar aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, me pasojë shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

74. Lidhur me të ardhurat e pretenduara të dërguara nga vëllai i nënës së bashkëshortit në favor të kësaj të fundit, në shumën 6,000 CAD në vit, vërehet se, përtej faktit, që nuk është provuar me dokumente ligjore pagesa e detyrimeve tatimore në vendin e origjinës, as nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion tjetër i kohës - veç deklaratave noteriale aktuale - lidhur me transferimin e këtyre fondeve në Shqipëri. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson pretendimin e subjektit të pabazuar dhe, si i tillë, mbetet në nivel deklarativ edhe pse influenca financiare e këtij burimi, në rezultatin final, do të ishte periferike.
75. Për sa më sipër, në konkluzion të analizës së dokumentacionit të administruar, të përgjigjeve dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të dokumentacionit provues të paraqitur prej saj, trupi gjykues vlerëson se nuk është provuar burimi i ligjshëm i këtyre të ardhurave të pretenduara dhe arrin në përfundimin se ato nuk duhen përfshirë në analizën financiare.
76. Në lidhje me pagesën në shumën 600,000 lekë nga “Alpha Bank”, në konkluzion të analizës financiare të kryer për të ardhurat e familjes së subjektit, rezulton se subjekti nuk arrin të justifikojë shumën prej 574,000 lekësh, për periudhën deri në vitin 2012, ndonëse jemi në një periudhë përpara fillimit të detyrës të subjektit dhe, për rrjedhojë, ekspozimi i saj në raport me këtë periudhë është indirekt, specifik dhe relativ.
77. Në lidhje me pretendimin për përfshirjen në analizën financiare të shumës prej 100,000 lekësh, depozitë e kryer nga shtetasi O. A., në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, trupi gjykues çmon se megjithëse është konstatuar se deklarimi i burimit nuk është pasqyruar i plotë dhe i saktë, *stricto legis* – për sa kohë depozitimi i kryer, nuk është përshkruar si burim në deklaratën e vitit 2014 – pasi ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, për justifikimin e burimit të ligjshëm të krijimit, ky konstatim i parë në harmoni me rezultatet e tjera, në tërësinë e çështjes, si dhe në raport me parimin e proporcionalitetit, trupi gjykues vlerëson se kjo pasaktësi nuk mund të mjaftojë për të aplikuar ndonjë masë për subjektin e rivlerësimit. Ky konkluzion arrihet, jo vetëm në bazë dhe nën dritën e qëndrimit të konsoliduar tashmë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, lidhur me pasojat e mundshme të pasaktësive në deklaratimet e pasurisë ndër vite, por edhe duke mbajtur në vëmendje faktin se përdorimi i kësaj shume përbën një pasaktësi në deklaram.
78. Në lidhje me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizë të shumës 134,883 lekë, të konstatuar si pamjaftueshmëri financiare nga Komisioni, për krijimin e kursimeve në shumën 2,500 euro, të përdorura më pas për blerjen e pasurisë në analizë, si dhe rishikimin e shpenzimeve të vitit 2013, trupi gjykues, pasi ka analizuar shpjegimet dhe provat e reja të paraqitura nga subjekti rivlerësimit, ka konkluduar se ndonëse shpenzimet e kryera për udhëtimet ishin deklaruar prej subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ato nuk ishin provuar më herët me dokumentacion ligjor. Konkretisht, lidhur me udhëtimet turistike në Korfuz dhe në Dubrovnik, subjekti ka paraqitur faturat nga ku provohet kostoja e qëndrimit. Në këto kushte, nga Komisioni u rillogaritën këto kosto, së bashku me koston për ushqim dhe shpenzime të tjera në masën 20 euro/ditë, duke i përlllogaritur në masën totale prej 960 euro dhe jo 635 euro, sa është pretenduar nga subjekti i rivlerësimit³¹. Në përfundim, balanca negative e konstatuar për këtë pikë në përfundim të hetimit ndryshon nga shuma 134,883

³¹Masa prej 5 euro/lekë xhepi, aplikohet vetëm në rastet kur subjektit apo personave të lidhur i janë mbuluar shpenzimet nga persona të tjerë.

lekë, në shumën 77,108 lekë.

2. Dy garazhe në përdorim, me vendndodhje në rrugën “S. e V.”, Tiranë

79. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë, përdorimin e pasurive të llojit garazh³², më vendndodhje rruga “S. e V.”, Tiranë, me vlerë 12,000 euro. Në lidhje me këto pasuri, subjekti ka deklaruar se janë të regjistruara në pronësi të shtetasit I. Gj. (babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit).
80. Në mbështetje të deklaramit të sipërcituar, subjekti ka depozituar në cilësinë e provës kontratën e shitblerjes nr. ***, të datë 15.7.2015, për dy garazheve me sipërfaqe 20 m² secili, me vlerë totale 12,000 euro, nga ku ka rezultuar shitës shoqëria “R.” sh.p.k. dhe blerës shtetasi I. Gj.. Në nenin 3 të kësaj kontrate, palët kanë deklaruar se çmimi i secilës prej pasurive ka qenë 6,000 euro dhe janë likuiduar tërësisht sipas kontratës së porosisë nr. *** dhe nr. **, datë 12.12.2014.
81. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka komunikuar me institucionet si vijon:
- Nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës³³, është bërë me dije për Komisionin se pasuritë e paluajtshme të llojit garazh, kanë rezultuar të regjistruara në pronësi të shtetasit I. Gj., duke vënë në dispozicion të Komisionit edhe kopje të kartelave, certifikatave të pronësisë të datës 8.6.2015, si dhe kontratën e shitblerjes të sipërcituar.
 - Nga Ministria e Drejtësisë³⁴, Sektori i Rregullimit të Profesionëve të Lira, Regjistri Noterial, është konfirmuar, kontrata e shitblerjes së sipërcituar si dhe dy kontrata porosisë me objekt “ndërtimi i një parkimi pranë Kopshtit Botanik”, dy garazhe me sipërfaqe 20 m², secili, me vlerë 12,000 euro, me nr. **, të datës 12.12.2014, ku ka rezultuar porositës i parë shtetasi V. Ç. dhe porositës i dytë shtetasi I. Gj. dhe palë sipërmarrëse shoqëria “R.” sh.p.k., si dhe kontratën me nr. **, datë 12.12.2014, ku porositës ka rezultuar shtetasi I. Gj., dhe sipërmarrës shoqëria “R.” sh.p.k.

2.1. Lidhur me burimin e të ardhurave për blerjen e pasurive të llojit “garazh”

82. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të bënte me dije lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të llojit “garazh” prej shtetasit I. Gj., duke paraqitur dokumentacionin ligjor përkatës mbi mënyrën dhe kohën e kryerjes së pagesës/ave për këto pasuri.
83. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se si burim për blerjen e pasurive në fjalë, vjehri i saj ka marrë një hua dhe ka paraqitur një deklaratë noteriale me nr. **, datë 27.5.2021, ku shtetasja B. Sh. ka deklaruar se i ka dhënë hua shtetasit I. Gj. shumën 8,000 GBP, për të blerë pasuritë e sipërcituara. Nga deklarata ka rezultuar se huadhënia është kryer *cash* në shtator të vitit 2014, pa afat dhe pa interesa dhe se nuk është formalizuar me dokument të shkruar, për shkak të marrëdhënies familjare dhe të mirëbesimit që palët

³²Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se pasuritë e llojit garazh janë përdorur prej saj dhe bashkëshortit të saj, për të parkuar automjetin e tyre, për rreth një vit e gjysmë, duke filluar prej fundit të muajit janar të vitit 2016 dhe deri në prill – maj të vitit 2017. Më pas këto pasuri janë përdorur për magazinimin e mallrave të aktivitetit tregtar të babait të bashkëshortit të subjektit (pronarit të tyre shtetasit I. Gj.).

³³Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2020, si dhe dokumentacioni bashkëlidhur.

³⁴Shkresë nr. *** prot., datë 11.3.2020.

kanë pasur mes tyre. Huadhënësja ka deklaruar se kjo hua vijon të jetë e palikuiduar, deri në momentin e nënshkrimit të deklaratës.

84. Në deklaratën e sipërcituar, huadhënësja ka deklaruar se shumë prej 8,000 GBP e ka përfituar si trashëgimtare e trashëgimlënësit S. F. V., trashëgimi e çelur në shtetin anglez dhe kredituar në llogarinë e saj nga studioja ligjore “R.K.S” në Angli. Për këtë shumë, huadhënësja ka deklaruar se e ka pasur gjendje në llogarinë e saj bankare në “Societe General Albania Bank” (sot “OTP Bank”).
85. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale me nr. ***, të datës 27.5.2021, nënshkruar nga vjehri i saj, shtetasi I. Gj., i cili ka deklaruar se ka marrë hua nga shtetasja B. Sh. në vlerën 8,000 GBP, për të blerë pasuritë e llojit garazh të përshkuara më sipër.
86. Lidhur me burimin e ligjshëm të huadhënësës, subjekti ka paraqitur lëvizjet bankare të llogarisë së saj, në të cilën është konstatuar një transfertë parash në shumë 10,064 GBP nga studioja ligjore “R. K. S.”, pa ndonjë përshkrim mbi arsyet e transfertës dhe tërheqja e shumave 2,000 GBP dhe 8,050 GBP në shtator të vitit 2014. Gjithashtu, nuk është provuar arsyeja dhe qëllimi i kryerjes së kësaj transferte nga shoqëria e huaj dhe ligjshmëria e saj.
87. Ndërkohë, subjekti ka paraqitur mandatpagesat e kryera nga vjehri për këto pasuri, nga ku ka rezultuar se janë kryer pagesat si vijojnë:
 - shuma 560,000 lekë në datën 12.12.2014, në favor të shtetasit V. Ç.;
 - shuma 3,000 euro në datën 12.12.2014, në favor të shoqërisë “R.” sh.p.k.;
 - shuma 420,000 lekë në datën 12.12.2014, në favor të shoqërisë “R.” sh.p.k.;
 - shuma 1,000 euro në datën 6.2.2015, në favor të shtetasit V. Ç.;
 - shuma 1,000 euro në datën 31.3.2015, në favor të shtetasit V. Ç..
88. Nga sa më sipër ka rezultuar se njëri prej garazheve në fjalë është porositur nga shtetasi V. Ç. dhe tjetri nga shoqëria “R.” sh.p.k., të cilët ndodhen në të njëjtën godinë me apartamentin e porositur në të njëjtin vit nga subjekti i rivlerësimit.
89. Komisioni vlerëson se nuk ka logjikë ekonomike në dhënien e huas në shumë 8,000 GBP, nga 10,000 GBP të përfituara, ndërkohë që në momentin e marrjes së shumës së pretenduar hua, vjehrit e subjektit kanë pasur gjendje në llogaritë e tyre bankare në banka të nivelit të dytë rreth 12,000,000 lekë, të cilat nuk janë përdorur. Po ashtu, nuk ka logjikë blerja e dy garazheve prej vjehrit të subjektit në qytetin e Tiranës – nga të njëjtat palë shitëse me ata të apartamentit të blerë prej bashkëshortit të subjektit – duke jetuar dhe punuar në qytetin e Elbasanit. Për më tepër, pas një periudhe 7-vjeçare nga momenti i deklarimit të marrjes së kësaj shume, ende nuk është shlyer, çka e bën jobindës burimin prej huas së mësipërme. Në këto kushte ngrihen dyshime se këto dy garazhe mund të jenë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit.
90. Në këto rrethana dhe në funksion të kryerjes së një hetimi të plotë dhe gjithëpërfshirës, Komisioni ka përlllogaritur mundësitë financiare të shtetasit I. Gj., në cilësinë e personit tjetër të lidhur, në momentin e porositjes të pasurive në fjalë.
91. Në vijim të analizës së prindërve të bashkëshortit të subjektit, të kryer mbi dhurimet në vitin 2012, në të cilën këta të fundit kanë rezultuar në pamundësi financiare, Komisioni ka marrë

në konsideratë të ardhurat për periudhën 2013 – mars 2015, në përfundim të së cilës ka rezultuar mungesë e burimeve të ligjshme financiare në vlerën 1,338,990 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

92. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatin e lartpërshkruar, veç të tjerash, ka shpjeguar sa vijon: [...] *“Transaksionet për blerjen e këtyre pasurive janë kryer nëpërmjet bankës. Huaja në shumën 8,000 GBP, nga shtetasja B. Sh. me të cilën vjehri ka lidhje gjinore dhe marrëdhënie miqësore dhe, për këtë arsye, nuk është materializuar në ndonjë akt të shkruar. Huaja është marrë në një kohë kur prindërit e bashkëshortit kanë pasur gjendje në llogaritë e tyre bankare në banka të nivelit të dytë rreth 12,000,000 lekë, të mbyllura në depozita me afat dhe nuk janë përdorur, pasi nëse do të tërhiqeshin përpara përfundimit të afatit do të humbisnin interesat. Për sa i përket faktit se kjo hua nuk është shlyer, ajo është marrëdhënie e vjehrit me këtë shtetase, në të cilën unë dhe bashkëshorti nuk jemi palë. Në periudhën kur janë paguar këto garazhe, kam punuar si ndihmësligjore në Gjykatën e Lartë, detyrë të cilën e kam kryer prej datës 10.4.2014 deri në datën 20.6.2016 dhe nuk kam pasur kompetenca vendimmarrëse. Për sa i përket analizës financiare, për vitin 2014 dhe janar-qershor 2015, kërkoj të përlllogariten edhe të ardhurat e kumatës, e cila referuar certifikatës së martesës, ka lidhur martesë në datën 23.7.2015”.*
93. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës:
- aktin origjinal (në gjuhën angleze) si dhe të përkthyer dhe të njëzuar me origjinalin, për çeljen e trashëgimisë në shtetin anglez të shtetasit S. F. V.;
 - certifikatën e martesës së kumatës së saj, si dhe pasaportën e cituar në raportin e sistemit TIMS, me mbiemrin e vajzërisë, si dhe kontratat e depozitave të vjehërrve të saj;
 - foto të garazhit ku ndodhet një automjet dhe disa kuti me materiale.

Vlerësimi i trupit gjykues

94. Në lidhje me pretendimin e subjektit se prindërit e bashkëshortit kanë pasur burime të mjaftueshme për blerjen e pasurive të llojit “garazh” dhe se kanë pasur në llogaritë e tyre bankare depozita me afat, të cilat nuk janë përdorur për të mos humbur interesat, nga hetimi ka rezultuar se kanë pasur disa depozita me shuma dhe maturitete të ndryshme, që janë liruar ndërkohë për t’u përdorur – së paku për kthimin pas të huas së pretenduar. Gjithashtu, dinamikat dhe shpjegimet e dhëna lidhur me huan në shumën prej 8.000 GBP, trupi gjykues çmon se mungon logjika ekonomike dhe nuk vlerësohet bindëse marrja e kësaj huaje dhe moskthimi i saj për shtatë vite, ndonëse burimet financiare nuk kanë munguar.
95. Përpos sa më lart, evidentohet fakti se lidhur me mundësitë financiare të prindërve të bashkëshortit të subjektit për blerjen e garazheve në fjalë, për shkak të ndryshimeve që analiza financiare ka pësuar në funksion të dokumenteve të lëshuara nga organet tatimore, pas mbylljes së rezultateve të hetimit, edhe duke mos e marrë në konsideratë huan e pretenduar, përfundimisht ka rezultuar se kanë pasur burime financiare për të blerë garazhet në fjalë, siç detajohet në vijim.
96. Nga ripërlllogaritja e analizës së të ardhurave të prindërve të bashkëshortit për blerjen e garazheve në fjalë, duke përfshirë këtu të ardhurat e periudhës 2013 – mars 2015 (kur është kryer pagesa përfundimtare e çmimit të blerjes së garazheve) dhe kursimet që rezultojnë nga

viti 2012 (si pasojë e shtimit në analizë të të ardhurave të aktivitetit të nënës për vitet 2009 – 2012), si dhe të ardhurat nga paga e babait të bashkëshortit (si i vetëpunësuar, për sa kohë këto paga janë konsideruar si shpenzim në bilancin e aktivitetit) ka rezultuar mjaftueshmëria financiare për këtë blerje – ndryshe nga sa kishte rezultuar në fazën e mbylljes së hetimit, ku ishte konstatuar pamundësia e prindërve për blerjen e këtyre garazheve.

Tabela nr. 5 – Të ardhurat e prindërve për blerjen e garazheve

	Pas prapesimeve	Ne rezultate
Të ardhura nga aktiviteti babait 2013-mars 2015	515 820	515 820
Të ardhura nga aktiviteti nënës 2013-mars 2015	638 879	335 229
Të ardhura nga paga B. Gjuzi 2013-mars 2015	1 095 654	466 488
Kursime të mbetura nga viti 2012	1 060 214	
Paguar 12,000 Euro për blerjen e garazheve	- 1 681 320	- 1 681 320
Shpenzime jetese 2013-mars 2015	- 975 206	- 975 206
Rezultati	654 041	- 1 338 990

97. Nisur nga ndryshimet e konstatimeve financiare dhe të konkluzioneve mbi mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare të prindërve të bashkëshortit të subjektit për blerjen e garazheve në fjalë, vërehet se ky fakt në vetvete, bën që të mungojë dyshimi i arsyeshëm i fshehjes së mundshme të pasurisë, pasi fakti i pasjes së disponibilitetit të mjeteve financiare të ligjshme nga ana e blerësve, passjell rrëzimin e njërit prej parakushteve për të hipotizuar një fshehje të mundshme të pasurisë dhe e përjashton këtë dyshim, për sa kohë pronari *de jure* ka pasur burime të ligjshme financiare për t'i mundësuar pikërisht kryerjen e këtij investimi në mënyrë të ligjshme. Kësisoj, vlerësohet si e pamjaftueshme vetëm ekzistenca e elementit të dytë (si parakusht për dyshime mbi fshehjen – pra përdorimi i pasurisë nga ana e familjes subjektit të rivlerësimit), ndonëse në rastin konkret bëhet fjalë për një përdorim të dypalësh, për sa kohë është shpjeguar se edhe prindërit e bashkëshortit të subjektit duke frekuentuar shpesh banesën e djalit të tyre të vetëm, i përdorin garazhet jo vetëm për parkimin e automjeteve të tyre, por edhe për depozitimin e materialeve si furnizim për aktivitetin tregtar, që blejnë me shumicë në Tiranë dhe më pas e transportojnë gradualisht në Elbasan.
98. Për rrjedhojë, nisur nga fakti që situata financiare ka rezultuar me bilanc pozitiv lidhur me blerjen e këtyre pasurive – pasi të dyja rezultatet e njoftuara lidhur me këtë pikë, kanë pësuar ndryshime si më lart, të cilat çojnë në konkluzionin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare për blerjen e garazheve, edhe pse nuk është konsideruar si burim huaja e pretenduar si e marrë nga shtetasja B. Sh. – dhe duke pasur parasysh se përdorimi i këtyre garazheve nuk ka qenë ekskluziv i subjektit, pasi ato janë përdorur edhe nga prindërit e bashkëshortit të saj – duke pasur në vëmendje edhe pohimin e subjektit gjatë seancës dëgjimore se blerja e këtyre pasurive ka qenë në lidhje me perspektivën e transferimit të prindërve të bashkëshortit për të jetuar së bashku, pasi të dalin në pension, si dhe deklarimit të saj se nëse këto pasuri do të kishin qenë të familjes së saj, ato mund të ishin blerë me ndihmën financiare të prindërve të bashkëshortit, sikurse ishte vepruar edhe për blerjen e apartamentit të banimit, trupi gjykues vlerëson se në këtë pikë nuk ekzistojnë më elemente të fshehjes së mundshme të pasurisë dhe shpjegimet e subjektit kanë rezultuar bindëse, së

paku lidhur me burimin e ligjshëm dhe, për rrjedhojë, për mospasje të arsyeve për të fshehur pasurinë në fjalë.

99. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se nuk mund të ketë ndonjë pasojë ligjore që i atribuohet subjektit të rivlerësimit, në kuadër të legjislacionit të zbatueshëm për rivlerësimin kalimtar, për sa kohë është arritur në konkluzionin se garazhet e babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të cilat ky i fundit i ka deklaruar në përdorim, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, justifikohen me burime të ligjshme. Në analizë të fakteve dhe rrethanave lidhur me përdorimin e tyre prej subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë faktin që mbështetja që i është dhënë nga babai, bashkëshortit, nuk mund të trajtohet teorikisht si një përfitim monetar që do të mund të vendoste palët në një marrëdhënie interesi pasuror sipas parashikimeve të nenit 3, të pikës 14, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë arrin në përfundimin se: (i) në kuadër të marrëdhënies së veçantë/ngushtë familjare që ekziston mes tyre; (ii) faktit të përdorimit të përbashkët të pasurive në fjalë; (iii) mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar krijimin e pasurive në fjalë; (iv) konstatimeve të Komisionit në rezultatet e hetimit kryesisht për kriterin e pasurisë lidhur me deklaratimet mbi periudhën/vitin në të cilin subjekti dhe familja e saj kanë filluar të jetojnë në zonën ku ndodhen këto pasuri; (v) faktit të blerjes prej babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit të dy garazheve, ndërkohë që ai rezulton të ketë automjet në pronësi dhe frekuenton shpesh banesën e djalit të vetëm, ku në të ardhmen mendon të transferohet së bashku me bashkëshorten, trupi gjykues lidhur me përcaktimin e situatës faktike të marrëdhënies reale të subjektit me këto pasuri të paluajtshme, çmon se nuk gjendet në rrethanat e parashikuara në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

3. Automjet i tipit “Mercedes-Benz C220”, me targa ***

100. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjet në vlerën 1,000,000 lekë, nga të cilat shuma 700,000 lekë është deklaruar si çmim blerjeje dhe shuma 300,000 lekë shpenzime për riparimin e automjetit, me burim përkatësisht nga të ardhurat e shitjes së automjetit të mëparshëm dhe dhuratë nga babai në vlerën 600,000 lekë. Dhurimi është formalizuar me deklaratë noteriale në prag të deklaratës *Vetting*.
101. Ky automjet ka rezultuar i deklaruar për herë të parë në deklaratën përpara fillimit të detyrës, në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, me të njëjtat burime, përfituar me anë të kontratës së shitblerjes me nr. ***, datë 28.6.2008, nga pala shitëse S. S., kundrejt çmimit 700,000 lekë.
102. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur veç kontratës së shitblerjes së automjetit edhe një deklaratë noteriale me nr. ***, datë 25.1.2017, e nënshkruar nga shtetasi I. Gj., në të cilën ky i fundit ka deklaruar dhurimin e shumës së sipërcituar ndaj shtetasit Q. Gj..
103. Përgjatë hetimit administrativ Komisioni ka komunikuar me institucionet si vijon:
- a. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor³⁵, gjatë procesit të hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dosjen e automjetit në fjalë, nga

³⁵Shkresë nr. *** prot., datë 26.2.2020.

e cila ka rezultuar se ky automjet është blerë fillimisht nga shtetasi S. S. në datën 20.6.2008 nga një shtetase gjermane, kundrejt çmimit 2,500 euro.

- b. Nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare³⁶ është bërë me dije për Komisionin se nga verifikimi i kryer ka rezultuar se në periudhën 2012 – 2017, subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar në emrin e tij automjetin me të dhënat e sipërcituara, si dhe ka rezultuar përdorues i automjetit me targa *** (i regjistruar në emër të babait I. Gj.).

Lidhur me burimet e krijimit të pasurisë

104. Subjekti i rivlerësimit ka përshkruar si burim të krijimit të kësaj pasurie: (a) të ardhura nga shitja e automjetit tip “Rover 200”, në vlerën 400,000 lekë; dhe (b) dhuratë nga babai i bashkëshortit në vlerën 600,000 lekë³⁷.
105. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se automjeti i mëparshëm tip “Rover 200”, është blerë fillimisht nga bashkëshorti i subjektit nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 6.2.2006, nga shtetasja L. A., kundrejt çmimit 200,000 lekë. Më pas, ky automjet është shitur nga bashkëshorti i subjektit nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 28.5.2008, kundrejt çmimit 500,000 lekë.
106. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të bënte me dije arsyet e shitjes së automjetit tip “Rover 200” me një çmim më të lartë se ai i blerjes pas 2 vitesh përdorimi, si dhe të paraqiste dokumentacionin ligjor për pagimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e realizuara nga kjo shitje.
107. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se çmimi i blerjes prej 200,000 lekësh ka qenë më i ulët se çmimi i tregut të automjetit, për shkak të marrëdhënies së posaçme të bashkëshortit të saj me palën shitëse, e cila është tezja e tij³⁸. Ndërsa, çmimi i shitjes prej tij në shumën 500,000 lekë ka qenë çmimi i tregut.
108. Subjekti ka bërë me dije se bashkëshorti ka paguar zhdoganimin e automjetit në vlerën 151,649 lekë, si dhe ka kryer shpenzime të tjera për targimin e automjetit, siguracionin dhe taksat vjetore, duke arritur vlerën totale rreth 500,000 lekë sa dhe është shitur. Për këtë arsye, subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e realizuara nga kjo shitje. Bazuar në sa më sipër, si dhe referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në analizën financiare Komisioni ka njohur të ardhura me burim të ligjshëm, në kuptim të shumës së barabartë me vlerën e blerjes dhe tarifën e zhdoganimit të paguar, 351,649 lekë.
109. Lidhur me shumën prej 600,000 lekësh, të dhuruar nga babai i bashkëshortit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka parashtruar se burimi i tyre ka qenë nga të ardhurat e tyre, ndër vite, nga aktivitetet tregtare, si dhe kursime të vjehrrës së subjektit nga shumat që i dërgonte i vëllai nga Kanadaja.
110. Në vijim të analizës së kryer mbi të ardhurat e prindërve të bashkëshortit të subjektit, Komisioni ka përllogaritur të ardhurat e tyre për një periudhë 6-mujore, deri në blerjen e automjetit në analizë. Pas përllogaritjes edhe të shpenzimeve jetike, ka rezultuar se subjekti

³⁶Shkresë r. *** prot., datë 28.2.2020.

³⁷Sipas deklaratës me nr. ***, të datës 25.1.2017.

³⁸Subjekti ka paraqitur certifikatë të gjendjes familjare të vitit 1974, të vjehrrës së saj dhe shtetases L. A., të cilat rezultojnë motra.

dhe bashkëshorti kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie në masën 574,781 lekë, për të cilën subjektit i ka kaluar barra e provës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

111. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatin e lartpërshkruar, ka shpjeguar sa vijon: “[...] automjeti në fjalë është blerë nga bashkëshorti kur unë sapo kisha mbaruar Fakultetin e Drejtësisë. Për blerjen e kësaj pasurie, ai ka përdorur të ardhurat e fituara nga shitja e automjetit ‘Rover 200’, i cili është shitur në vlerën 500.000 lekë, duke mos paguar tatim mbi të ardhurat, fakt ky që i është shpjeguar në atë kohë nga noterja pasi ai kishte kryer shpenzime për këtë mjet. Këto shpenzime janë kryer mbi 13 vjet më parë dhe bashkëshorti nuk ka ruajtur fatura, për këtë arsye nuk mund të penalizohem dhe as të ngarkohem me barrë prove mbi to. Si burim për krijimin e kësaj pasurie ka shërbyer edhe një shumë me përafërsi 600,000 lekë që bashkëshortit ia ka dhënë babai i tij. Në analizën financiare duhet të ish in përfshirë si burim i të ardhurave të prindërve të bashkëshortit, edhe të ardhurat që i dërgonte vëllai i saj nga Kanadaja”.

Vlerësimi i trupit gjykues

112. Lidhur me pretendimin e subjektit për mospagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit të mëparshëm, për arsye se në vlerën e automjetit janë përfshirë shpenzimet e kryera për riparimin e tij, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim është i papabuar dhe nuk mund të merret në konsideratë. Përkundër shpjegimeve të subjektit, të cilat bien ndesh me përcaktimin e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës mbi ligjshmërinë e të ardhurave dhe detyrimin kushtetues të përmbushjes së detyrimeve përkatëse tatimore, trupi gjykues çmon se nuk mund të konsiderohen si burime të ligjshme të ardhurat për të cilat nuk janë paguar detyrimet tatimore.
113. Për sa i përket pretendimit të subjektit për të përfshirë në analizë të ardhurat e nënës së bashkëshortit të dërguara nga vëllai i saj në Kanada, trupi gjykues vlerëson dhe konkludon si pikën e mësipërme, ku ky pretendim është trajtuar në raport me pasurinë e parë.
114. Ndërsa në lidhje me pretendimin për të përfshirë në analizë të ardhurat nga aktiviteti i nënës dhe ato nga pagat e babait të bashkëshortit – siç është argumentuar edhe më sipër – trupi gjykues e ka marrë në konsideratë këtë pretendim, duke i përfshirë në analizë të ardhurat e disa viteve, për të cilat dokumentacioni provues nga organet tatimore është administruar pas mbylljes së hetimit administrativ. Pas përfshirjes në analizën financiare të të ardhurave të sipërcituara, balanca negative për këtë pasuri tashmë rezulton në vlerën negative prej – 186,509 lekësh (nga – 574,781 lekë që ishte në rezultatet e njoftuara), ky ndryshim reflektohet në detajimet e shifrave, në tabelën në vijim.

Tabela nr. 6 – Analiza e burimeve për blerjen e pasurisë

	Pas prapesimeve	Ne rezultate
Të ardhura nga aktiviteti babait	278 500	278 500
Të ardhura nga paga babait	72 121	-
Të ardhura nga aktiviteti nënës	316 151	-
Të ardhura nga shitja e automjetit ekzistues	351 649	351 649
Shpenzim për blerjen e automjetit	- 1 000 000	- 1 000 000
Shpenzime janar - qershor 2008	- 204 930	- 204 930
Rezultati	- 186 509	- 574 781

4. Llogari rrjedhëse në shumën 77,815 lekë, në emër të subjektit, në “Raiffeisen Bank”

115. Nga lëvizjet bankare të llogarive të subjektit të rivlerësimit është konfirmuar gjendja në llogarinë bankare të pagës së subjektit, e cila përputhet me shumën e deklaruar në deklaratën *Vetting*, si dhe është konfirmuar burimi nga të ardhurat nga pagat.

5. Llogari rrjedhëse në vlerën 143,340 lekë, në emër të bashkëshortit, në “Alpha Bank”

6. Llogari rrjedhëse në vlerën 268,597 lekë, në emër të bashkëshortit, në BKT

7. Llogari rrjedhëse në vlerat 644 euro dhe 6,046 USD, në emër të bashkëshortit, në “Raiffeisen Bank”

116. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, janë konfirmuar gjendjet e disponuara në llogaritë e tij bankare, të cilat përputhen me shumën e deklaruar në deklaratën *Vetting*.

117. Sa i përket burimit të krijimit të gjendjeve në llogaritë e mësipërme bankare, ka rezultuar se për llogarinë në “Alpha Bank”, shumën në fjalë është krijuar nga depozitimi i shumës prej 100,000 lekësh nga shtetasi O. A. dhe nga të ardhurat nga interesat, për të cilat nuk janë konstatuar problematika.

118. Sa i përket gjendjes në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në BKT është konfirmuar burimi i krijimit të shumës me të ardhurat e tij nga pagat, të transferuara nga punëdhënësi “D.” sh.p.k.

119. Gjendja në llogarinë në euro në “Raiffeisen Bank” rezulton të jetë krijuar nga shumën prej 8,000 euro (e dhuruar prej prindërve) dhe 2,500 euro (të depozituara prej tij), si dhe interesat e depozitës ndër vite. Më pas, shumën prej 10,000 euro është transferuar për blerjen e pasurisë së trajtuar në pikën 1 dhe ka mbetur në llogari gjendja e deklaruar.

120. Gjendja në llogarinë në dollarë në “Raiffeisen Bank” rezulton të jetë krijuar nga dhurimi prej prindërve të bashkëshortit të subjektit të shumës 6,000 USD dhe interesave të përfituara ndër vite. Në vijim të analizës së kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit ka rezultuar se të ardhurat e prindërve të bashkëshortit të subjektit gjatë kësaj periudhe kanë qenë 1,279,947 lekë, ndërkohë që shpenzimet e jetesës kanë qenë në masën 1,652,652 lekë, dukshëm më të larta se të ardhurat e dokumentuara. Për rrjedhojë, duket se kanë pasur një pamjaftueshmëri totale të burimeve të ligjshme, edhe për depozitimin e shumës prej 6,000 USD, si dhe shumës prej 639,420 lekësh.

121. Nga analiza e lëvizjeve në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit ka rezultuar se në datën 15.1.2013, në llogarinë e këtij të fundit pranë ish-Bankës Veneto (sot “Intesa Sanpaolo Bank”), është transferuar një shumë prej 480,000 lekësh, nga shoqëria “B. V.”, me përshkrimin “dhënie borxhi”. Kjo shumë rezulton të jetë tërhequr prej bashkëshortit të subjektit në të njëjtën datë. Ndërkohë, përgjatë shqyrtimit të DIPP-ve të vitit 2013 e në vijim, nuk ka rezultuar të jetë deklaruar kjo marrëdhënie huamarrjeje, përfshirë edhe deklaratën *Vetting*.
122. Lidhur me këtë hua, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, në përgjigje të të cilit subjekti ka bërë me dije se bashkëshorti ka pasur një llogari në “Intesa Sanpaolo Bank”, por nuk ka kryer lëvizje nëpërmjet saj. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur një vërtetim të datës 31.5.2021 nga “Intesa Sanpaolo Bank”, që ka bërë me dije se në emër të shtetasit Q. Gj. nuk ka pasur llogari tjetër në këtë bankë, veç asaj të çelur më 1.1.2007 dhe të mbyllur më 3.11.2008.
123. Ndonëse subjekti ka paraqitur vërtetimin e mësipërm nga “Intesa Sanpaolo Bank”, e njëjta bankë – e cila ka përthithur edhe Bankën Veneto – ka bërë me dije se bashkëshorti i subjektit ka pasur llogari pranë kësaj banke³⁹ dhe i ka bashkëngjitur shkresës me nr. *** prot., datë 3.3.2020 edhe lëvizjet bankare të llogarisë së bashkëshortit të subjektit, në të cilat është konstatuar dhe transaksioni i lartpërmendur. Për më tepër, nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-së ka rezultuar se ortakët e shoqërisë huadhënëse “B. V.” sh.p.k. janë të njëjtët ortakë edhe të shoqërisë “D.” sh.p.k. dhe “XH. B., në të cilat është/ka qenë i punësuar bashkëshorti i subjektit. Për rrjedhojë, ndryshe nga sa është pretenduar nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit, veprimi financiar në fjalë duket se i përket dhe është kryer pikërisht në favor të këtij të fundit, sikurse rezulton nga dokumentacioni bankar i administruar nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

124. *“Në lidhje me mosdeklarimin e shumës prej 480.000 lekësh, sqaroj se nuk bëhet fjalë për një hua, por për një shumë të kaluar nga shoqëria ‘B. V.’, për llogari të personit juridik, shoqërisë ‘D.’ sh.p.k., e cila i është kaluar bashkëshortit në vend që të kalohej direkt në llogarinë e shoqërisë ‘D.’ sh.p.k. Këtë shumë ai e ka tërhequr dhe një pjesë e ka depozituar brenda të njëjtës ditë në llogarinë e shoqërisë ‘D.’ sh.p.k., për të kryer kjo e fundit një pagesë TVSH-je për Doganën Durrës, ndërsa me pjesën tjetër ka paguar agjencinë doganore, ngarkim-shkarkimin në port, transportin deri në magazinë po për llogari të shoqërisë ‘D.’ sh.p.k. Bashkëshorti im këtë veprim nuk e ka deklaruar pasi nuk e ka mbajtur mend”.*
125. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës:
- a. deklaratë të ortakut G. D.;
 - b. statement të llogarisë në BKT të shoqërisë “D.” sh.p.k., për depozitimin e shumës nga Q. Gj. (punonjës) dhe kryerjen e pagesës për zhdoganimin në po të njëjtën ditë.

³⁹Në përgjigje është cituar se: Q. I. Gj., i datëlindjes 17.6.1983 ka pasur llogari në “Intesa Sanpaolo Bank”, ish- “Veneto Bank” me nr. *** (Base number – NDG).

Vlerësimi i trupit gjykues

126. Në lidhje me pretendimin e mësipërm, pas administrimit të dokumentacionit të paraqitur, si dhe shpjegimeve të saj, trupi gjykues i konsideron bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti.

8. Lidhur me gjendjen *cash* në vlerën 10,000 lekë, jashtë sistemit bankar

127. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, në vlerën 10,000 lekë. Si burim për krijimin e kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga paga nga të cilat, gjendje *cash* jashtë sistemit bankar në vlerën 500,000 lekë në datën 31.12.2015, shtuar me 25,000 lekë kursime nga paga e muajit janar, pakësuar në vlerën 280,000 lekë, në datën 1.2.2016 për pagesë kësti të huas, sipas deklaratës me nr. ***, të datës 15.7.2015, shtuar me vlerën 145,000 lekë, pakësuar me vlerën 380,000 lekë për shpenzime mobilimi.
128. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti dhe bashkëshorti kanë deklaruar gjendje të disponuar *cash* në banesë, së bashku vlerën 600,000 lekë, nga të cilat 500,000 lekë të subjektit dhe 100,000 lekë të bashkëshortit. Nga analiza financiare ka rezultuar se mund të realizoheshin kursimet e deklaruara me burime të ligjshme financiare. Më pas në DIPP- në e vitit 2016, kanë deklaruar përkatësisht pakësimet në gjendjet e tyre të disponuara *cash* në banesë, për mobilimin e shtëpisë, duke deklaruar edhe gjendjen e mbetur prej 10,000 lekësh. Nga sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit të kësaj shume.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

129. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në Aneksin 1 që i bashkëngjitet këtij dokumenti, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
130. Në analizën e njoftuar subjektit, në të cilën ishin konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2012, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, pranë ILDKPKI-së, ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ, për të kryer të gjitha investimet, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, në shumën totale – 4,311,686 lekë, për të cilin subjektit i ka kaluar barra e provës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

131. Subjekti ka parashtruar se: *“Nga Komisioni nuk është mbajtur parasysh që gjatë periudhës së rivlerësimit (2013 – 2016) kam punuar gjithsej si gjyqtare 7 muaj e 20 ditë. Nuk jam dakord me analizën financiare për arsyet e poshtërenditura:*
- *Analiza financiare për periudhën e rivlerësimit, duhet të fillojë prej datës 10.10.2012 e në vijim.*

- *Shumat 8,000 euro dhe 6,000 dollarë që i ka dhuruar nëna bashkëshortit në bankë në datën 5.11.2012 justifikohen/mbulohen plotësisht me burime të ligjshme, ndaj duhet të hiqet nga balanca negative vlera 1,757,180 lekë.*
- *Në vitin 2014 balanca negative prej -1,379,830 krijohet pasi është konsideruar e ligjshme vetëm shuma prej 1,440,411 lekësh, në vend të 3,000,000 lekë që është kaluar realisht. Kjo shumë që i është transferuar bashkëshortit provohet se është krijuar prej tyre në vitin 2007, ndaj për sa kohë kanë qenë të depozituara në bankë përpara fillimit të detyrës, duhet të konsiderohen të ardhura të ligjshme.*
- *Është përfshirë në shpenzimet për mobilim në vitin 2015 një shumë prej 460.588 lekësh, e cila është vlera e faturës nr. ***, datë 8.10.2015. Ky konkluzion vjen në kundërshtim me provat. Detyrimi i sipërcituar është paguar në datën 4.10.2019 me anë të bankës, ndaj duhet t'i zbritet kjo vlerë shpenzimeve të mobilimit të vitit 2015.*
- *Shpenzimet e mobilimit janë llogaritur në vlerën 480,000 lekë. Ju sqaroj se në deklarin periodik vjetor të vitit 2016 janë deklaruar prej meje shpenzime mobilimi 380,000 lekë me përafërsi, ndërkohë që pasi i kam saktësuar ato në kuadër të kthimit të përgjigjeve të pyetësorit të parë të dërguar nga ju, më kanë rezultuar 335,000 lekë.*
- *Llogariten njësoj si shpenzime të kryera për udhëtime jashtë shtetit, udhëtimet në drejtim të Bajram Currit, i cili është pjesë e territorit të shtetit shqiptar. Sa më sipër, shpenzimet e udhëtimit për në Tropojë nuk duhet të llogariten më vete pasi ato janë të përfshira në anketën e buxhetit të familjes, pasi janë brenda limitit për shpenzimet për transport familjar. Subjekti është shprehur se ka qëndruar në banesën e shtetasit Skënder Selimaj dhe ka shkuar për shkak të sebepeve familjare të tyre.*
- *Shpenzimet e udhëtimit për në Berat janë llogaritur gabim pasi në 2 muaj në vitin 2014 dhe 5 muaj në vitin 2016, subjekti ka pretenduar se ka udhëtuar disa herë me mjete të transportit publik, por shumicën e kohës me kolegët, të cilët kryenin funksionin në Berat, por jetonin në Tiranë. Shpenzimet e udhëtimit për në Berat kanë variuar nga 10,000 në 15,000 lekë/muaj, ndaj duhet të rillogariten.*
- *Në ndryshimin e likuiditetit të vitit 2013, me shumën 717,363 lekë, është përfshirë një vlerë prej 220,000 lekësh, e cila në fakt ka si burim të ardhurat e shtetasve M. E., A. F., O. A.. Sa më sipër, duhet të shtohet shuma 220,000 lekë si burim të ardhurash, ose të zbritet nga bilanci negativ kjo shumë”.*

Vlerësimi i trupit gjykues

132. Në vijim të analizimit të pretendimeve të subjektit mbi analizën financiare është rishikuar kjo e fundit duke u shtuar shuma prej 220,000 lekësh (dhurimet nga miqtë e bashkëshortit) si e ardhur në vitin 2013, duke u përfshirë shuma e dhuruar nga prindërit e bashkëshortit në vitin 2012 prej 1,757,180 lekësh (8,000 euro dhe 6,000 USD), duke u përfshirë shuma prej 2,411,946 lekësh (si e ardhur me burim të ligjshëm nga dhurimi i shumës prej 3,000,000 lekësh), duke zbritur shpenzimet e transportit për në Berat sipas pretendimeve të subjektit, duke zbritur shpenzimet e udhëtimit për ato të kryera nga bashkëshorti për qëllime pune dhe

për të cilat janë mbuluar shpenzimet nga punëdhënësi, si dhe duke zbritur pjesërisht shpenzimet e udhëtimeve turistike sipas faturave të paraqitura për rezervimet e hoteleve.

133. Lidhur me përfshirjen pa të drejtë nga Komisioni, në shpenzimet e mobilimit të shumës prej 460,588 lekësh, kjo shumë duke qenë se nuk ishte paguar prej subjektit gjatë vitit 2015, në këtë vit është përfshirë në analizë gjithashtu edhe si detyrim i mbetur, çka neutralizon efektin në analizën financiare, për rrjedhojë subjektit në analizë nuk i janë ngarkuar shpenzime *extra*.
134. Lidhur me shpenzimet e mobilimit të vitit 2016, në DIPP-në e këtij viti, subjekti ka deklaruar pakësimin e kursimeve të saj me 380,000 lekë për shpenzime mobilimi, ndërkohë që bashkëshorti i saj ka deklaruar në deklaratën e personit të lidhur të po këtij viti pakësimin e kursimeve të tij prej 100,000 lekësh për arredim dhe, për rrjedhojë, në analizë janë përfshirë të dyja shumatat e shpenzuara nga familja prej 480,000 lekësh në total.
135. Nga Komisioni është kryer analiza financiare e vitit 2012, duke u ndarë periudha 1.1.2012 – 10.10.2012 dhe periudha 10.10.2012 – 31.12.2012, si pasojë e së cilës balanca negative e këtij viti do të ndahet në - 227,117 lekë për periudhën e parë dhe – 480,535 lekë për periudhën e dytë.
136. Në përfundim të sa më sipëranalizuar, për të gjithë vlerësimin e kriterit të pasurisë nga analiza financiare e rishikuar, për periudhën tetor 2012 – 2016, ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në masën – 900,050 lekë.

Aneksi nr. 1 – Analiza financiare për periudhën tetor 2012 – 2016

Viti	10.10-31.12.12	2013	2014	2015	2016
PASURI	2 367 272	717 363	5 223 165	309 294	-269 625
Automjet Mercedes Benz, TR***R					
Apartament me sip. 108,9 m2, Selitë e Vjetër, Tiranë			8 680 000		
Ndryshim likuiditeti	2 367 272	717 363	-3 456 835	309 294	-269 625
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	4 069 008	4 786 371	1 329 536	1 638 829	1 369 205
DETYRIME	0	0	1 680 000	460 588	-543 540
Detyrim për blerjen e apartamentit V.Ç.			1 680 000		-543 540
Detyrim për pajisjet e kondicionimit A.T. Shpk				460 588	
PASURI NETO	2 367 272	717 363	3 543 165	-151 294	273 915
Të ARDHURA dokumentuar	2 015 005	1 503 499	3 994 003	1 481 874	1 713 213
Të ardhura SR të vërtetuara	194 840	807 290	979 244	977 941	1 060 601
Të ardhura B/sh të vërtetuara	62 985	476 209	602 813	503 933	502 613
Dhuratë nga prindërit e b/shortit	1 757 180		2 411 946		150 000
Dhurata nga miqtë e b/shortit		220 000			
SHPENZIME	128 268	758 656	870 036	1 495 436	1 439 615
Shpenzime jetese	105 768	423 072	659 994	672 828	705 276
Shpenzime mobilimi				630 488	480 000
Shpenzime udhëtimi	0	175 584	56 892	21 320	163 539
Shpenzime transporti TR-BR			30 000		75 000
Shpenzime siguracion automjeti		12 500	17 650	15 800	15 800
Shpenzime për unionin e gjyqtarëve		8 000	11 000	11 000	
Shpenzime qiraje	22 500	139 500	94 500	144 000	
Analiza dokumentuar	-480 535	27 480	-419 199	137 733	-317
CASH në Lekë			300 000	600 000	10 000
DIFERENCA E PA MBULUAR			-900 050		

137. Në përfundim, duke e vlerësuar kriterin e pasurisë për këtë subjekt rivlerësimi, në tërësinë e tij dhe nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit, trupi gjykues çmon

se pamjaftueshmëria financiare e sipërpërmendur në vlerën totale 900,050 lekë (duke mbajtur në vëmendje sa është shprehur në paragrafin nr. 69 dhe nr. 73), nuk përbën shkak të mjaftueshëm për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të znj. Adelajda Gjuzi, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se znj. Adelajda Gjuzi ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm të gjitha pasuritë e analizuara.

B. KONTROLLI I FIGURËS

138. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë në Komisionit një raport për subjektin e rivlerësimit me nr. *** prot., datë 30.10.2017, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Adelajda Gjuzi.
139. Në vijim të kërkesës së Komisionit për përditësimin e rastit në fjalë, nga DSIK-ja janë përcjellë disa shkresa përditësuese, konkretisht të datave 31 maj dhe 2 e 16 qershor 2021, nëpërmjet të cilave bëhet me dije se, edhe për periudhën pas raportit të lartpërmendur, nuk disponohen të dhëna mbi përfshirje të mundshme në aktivitete të kundërligjshme për subjektin e rivlerësimit Adelajda Gjuzi.
140. Gjithashtu, DSIK-ja i ka bërë me dije Komisionit se raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Adelajda Gjuzi ishte deklasifikuar plotësisht më 16.2.2021.
141. Për rrjedhojë, në vijim të komunikimeve me organet ligjzbatuese dhe përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, për sa kohë nuk kanë rezultuar informacione apo fakte/rrethana të reja për subjektin e rivlerësimit, lidhur me këtë kriter, që mund të ngrinin dyshime mbi bazueshmërinë e konkluzioneve të arritura nga Grupi i Punës, pranë DSIK-së, edhe trupi gjykues e vlerëson subjektin të përshtatshëm për të vijuar detyrën.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

C/1. Lidhur me analizën e aftësive profesionale nga KLGJ-ja

142. KLGJ-ja ka përcjellë në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 21.1.2021, raportin e përpiluar nga ky institucion për analizimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të subjektit të rivlerësimit Adelajda Gjuzi.
143. Në raportin e KLGJ-së janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (i) aftësisë profesionale; (ii) aftësisë organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe (iv) aftësisë personale dhe angazhimit profesional. Raporti në fjalë është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, (iii) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

144. Sipas këtij raporti: (i) subjekti i rivlerësimit Adelajda Gjuzi ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret; (ii) gjyqtarja, përgjithësisht, përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të së drejtës si parimi i zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, parimin e disponibilitetit të padisë. Përrjashtimisht është evidentuar si e vetmja mangësi ligjore në dosjen nr. 2, ku është konkluduar se: *“Konstatohet se propozimi i ndihmësit ligjor Adelajda Gjuzi për mënyrën e zgjidhjes së çështjes, nuk përputhet me vendimmarrjen e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka arsyetuar dhe vendosur ndryshe nga sa është propozuar nga subjekti i rivlerësimit”*.
145. Për t’u vlerësuar gjithashtu është fakti që gjyqtare Adelajda Gjuzi në vendimet e dhëna prej saj, kur është rasti, përdor referenca nga Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nga Jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë, etj.
146. Së fundi, ndër tri dokumentet ligjore dhe një dosje e vëzhguar, janë ankimuar 2 prej tyre dhe në të dy rastet, vendimi i dhënë nga gjyqtare Adelajda Gjuzi është lënë plotësisht në fuqi nga Gjykata e Apelit⁴⁰.
147. Subjekti i rivlerësimit Adelajda Gjuzi, në cilësinë e gjyqtares, ka shfaqur aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Në cilësinë e ndihmësligjorit në Gjykatën e Lartë evidentohen cilësi të mira në arsyetimin ligjor në katër relacionet e vëzhguara.
148. Në lidhje me detyrën e ndihmësligjorit të kryer nga znj. Adelajda Gjuzi në Gjykatën e Lartë, në aktvlerësimet e kësaj të fundit, kryer për periudhat 2014 - 2015 dhe prill 2015-prill 2016, evidentohet fakti se subjekti i rivlerësimit jep mendime të argumentuara ligjërisht për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve penale. Ajo është vlerësuar nga Gjykata e Lartë se është e aftë të shkruajë thjesht dhe qartë projekt-vendimet gjyqësore, që rezultojnë të kuptueshme nga të gjithë.

C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

149. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku, si dhe duke analizuar aktet/vendimet/dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.
150. Komisioni, nga vlerësimi i tre dosjeve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet e përzgjedhura sipas një sistemi rastësor/me short, nuk ka konstatuar problematika apo shkelje të rënda lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, përtej disa mospërputhjeve midis relacionit/zgjidhjes ligjore të çështjeve të propozuara prej saj dhe qëndrimit ndryshe të Gjykatës së Lartë në vendimin përfundimtar – mbi të cilat ishte shprehur edhe KLGJ-ja.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

151. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ lidhur me këtë konstatim, subjekti

⁴⁰Shihni dokumentet 1 dhe 3.

i rivlerësimit ka shpjeguar se: “Për sa i përket mospërputhjes së mendimit të dhënë në cilësinë e ndihmësligjorit, për mënyrën e zgjidhjes së çështjes/vendimmarrjen e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka arsyetuar dhe vendosur ndryshe nga sa është propozuar unë sqaroj se kolegji, ndryshe nga sa ka parashtruar KLGJ-ja në raportin përcjellë pranë Komisionit, ka vlerësuar se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale, Kolegji Penal ka vendosur kalimin për gjykim të kësaj çështjeje dhe jo mospranimin e rekursit, sikurse ka konstatuar KLGJ-ja. Gjithashtu sqaroj se në fushën e interpretimit të ligjit nuk ka interpretim të saktë apo të gabuar, përveçse kur këtë e konstatojnë një gjykatë më e lartë, por interpretime të ndryshme”.

Vlerësimi i trupit gjykues

152. Nisur nga sa më lart, në raport me sa ka rezultuar nga aktet dhe dokumentet e administruara, si dhe duke mbajtur në vëmendje shpjegimet e paraqitura nga subjekti, trupi gjykues çmon se, vendimi i marrë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka qenë i ndryshëm nga mendimi/propozimi i subjektit të rivlerësimit. Shpjegimi i subjektit se mund të bëhet fjalë për një interpretim ndryshe, dhe jo të gabuar, vërehet që pabazueshmëria sugjeruese, e shprehur nga subjekti përgjatë funksionit të ndihmësligjorit, është konstatuar nga një gjykatë, pikërisht nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nëpërmjet qëndrimit dhe arsytimit ndryshe në vendimin përkatës dhe, për rrjedhojë, shpjegimi i subjektit mbi këtë pikë nuk duket bindës. Megjithatë, duke e parë në tërësinë e vet rivlerësimin e aftësive profesionale, këto problematika nuk përbëjnë shkak penalizues, për sa kohë nuk kanë rezultuar shkelje të rënda procedurale dhe/ose mosrespektim të të drejtave të palëve, me pasoja për këta të fundit apo arsyttime të dobëta ose të paplota në vendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

DENONCIME NGA PUBLIKU

153. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, deri në këtë fazë të hetimit, janë paraqitur nga publiku 7 denoncime, dy prej të cilave i përkasin të njëjtës çështje të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit dhe janë depozituar nga i njëjti denoncues. Të gjitha denoncimet janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim, lidhur me disa denoncime, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore, për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur, ka rezultuar si vijon:

1. Denoncimi nr. * prot., datë 24.4.2019 i shtetasit S. N.**

154. Shtetasi S. N. ka akuzuar disa subjekte rivlerësimi dhe ndërmjet tyre edhe gjyqtaren Adelajda Gjuzi, për mosrespektim formal të ligjit dhe arsyetim arbitrar, duke favorizuar njëri palë në vendimin nr. *** , datë 27.3.2018, duke trajtuar kontratën e huas si kontratë porosie, si dhe ka pretenduar se gjykata nuk ka ushtruar ekspertim lidhur me pretendimet e të paditurit.
155. Komisioni i është drejtuar me kërkesë gjykatës përkatëse, e cila, nëpërmjet shkresës me nr. *** prot., datë 28.5.2021, ka vënë në dispozicion të Komisionit vendimin objekt denoncimi. Nga analiza e vendimit të sipërcituar, në lidhje me pretendimin se gjykata

duhet ta kishte trajtuar marrëdhënien e palëve si një kontratë porosie dhe jo huaje, Komisioni vlerëson se ky pretendim lidhet me themelin e çështjes dhe, për rrjedhojë, nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga ky institucion.

156. Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se gjatë gjykimit nuk është thirrur eksperti financiar, nga shqyrtimi i vendimit ka rezultuar se në faqen nr. *** të vendimit është cituar se: “ *Gjykata pranoi kërkesën e palës paditëse për të kryer një aktekspertimi kontabël*”. Gjithashtu, në vendim kanë rezultuar të përlogaritura shpenzimet gjyqësore edhe për ekspertin kontabël.
157. Gjatë hetimit administrativ është konstatuar se vendimi i sipërcituar është ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.
158. Në këto kushte nuk janë konstatuar *indicie* për thellimin e hetimit, pasi denoncimi nuk referon ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit, sikurse as Gjykata e Apelit nuk ka ngritur dyshime mbi shkelje të mundshme procedure, ndërkohë që denoncimi në fjalë i referohet themelit të çështjes gjyqësore që nuk është objekt i procesit të rivlerësimit.

2. Denoncimi nr. * prot., datë 30.5.2019 i shtetasit M. K.**

159. Shtetasi M. K. ka depozituar denoncimin, në të cilin ngre pretendime për vendimmarrje të padrejtë dhe shkelje të procedurave nga subjekti i rivlerësimit Adelajda Gjuzi, por nuk përshkruan shkelje procedurale specifike. Bashkëlidhur denoncimit rezulton vendimi nr. *** , datë 2.5.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për çështjen me objekt “pushimi i procedimit nr. *** , i vitit 2017, regjistruar për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”. Nga shqyrtimi i vendimit ka rezultuar se ky vendim është dhënë nga një tjetër subjekt rivlerësimi dhe, për rrjedhojë, nuk mund të shqyrtohet nga kjo trupë gjyqësore.

3. Denoncimet nr. * prot., datë 10.3.2020 dhe nr. *** prot., datë 13.7.2020 të shtetasit L. S.**

160. Shtetasi L. S., nëpërmjet formularit të denoncimit, ka denoncuar disa subjekte rivlerësimi dhe ndërmjet tyre edhe gjyqtaren Adelajda Gjuzi për vendimmarrje të padrejtë dhe shkelje të procedurave, në çështjen e gjykuar prej saj. Në vendimin objekt denoncimi me nr. *** , datë 5.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, të dhënë nga subjekti Adelajda Gjuzi, është vendosur pranimi pjesërisht i kërkesës për pushimin e çështjes për sa i përket akuzës për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe neni 328/1/b i Kodit të Procedurës Penale, pasi fakti nuk përbën vepër penale, si dhe kthimin e akteve të procedimit penal nr. *** , viti 2017 Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për hetime të mëtejshme. Vendimi ka rezultuar i ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. *** , datë 5.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.
161. Në këto kushte nuk janë konstatuar *indicie* për thellimin e hetimit, pasi denoncimi nuk referon ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit dhe as

Gjykata e Apelit nuk ka evidentuar shkelje të mundshme procedure, ndërkohë që denoncimi i referohet themelit të çështjes gjyqësore.

4. Denoncimi nr. * prot., datë 27.1.2021, i shtetasit B. T.**

162. Shtetasi B. T. ka depozituar denoncimin, në të cilin ngre pretendime për vendimmarrje të padrejtë dhe shkelje të procedurave, në lidhje me vendimin nr. ***, datë 7.10.2020, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit Adelajda Gjuzi, pa përshkruar shkelje procedurale specifike.
163. Duke qenë se denoncuesi nuk ka bashkëlidhur kopje të vendimit objekt denoncimi, Komisioni i është drejtuar me kërkesë⁴¹ Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për vënien në dispozicion të kopjes së vendimit nr. ***, datë 7.10.2020.
164. Ndonëse denoncuesi nuk ka referuar ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka shqyrtuar vendimin⁴² dhe ka konkluduar se nuk janë konstatuar shkelje procedurale.

5. Denoncimi nr. * prot., datë 20.4.2021, i shtetasit N. M.**

165. Shtetasi N. M. ka depozituar denoncimin, në të cilin ngre pretendime për vendimmarrje të padrejtë dhe shkelje të procedurave nga subjekti i rivlerësimit Adelajda Gjuzi në vendimin nr. *** Akti, datë 31.3.2021, duke përshkruar si shkelje procedurale germën “b”, të pikës 1, të nenit 101, të Kodit të Procedurës Civile, padia është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile (nenet 564 dhe 610) dhe se gjykata nuk ka marrë në konsideratë përcaktimin sipas nenit 203/2 të Kodit të Procedurës Civile. Bashkëlidhur denoncimit nuk ka rezultuar bashkëlidhur vendimi objekt ankimi i datës 31.3.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.
166. Nga sa më sipër, me qëllim thellimin në hetimin administrativ, Komisioni i është drejtuar me kërkesë gjykatës, për vënien në dispozicion të vendimit. Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se padia është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile, konkretisht nenet 564 dhe 610 të Kodit të Procedurës Civile, nga shqyrtimi i vendimit ka rezultuar se gjykata në faqen nr. *** të vendimit ka argumentuar se në lidhje me pretendimin për tejkalimin e afatit 5-ditor nuk mund të shprehet në vendimin për sigurimin e padisë, por do të shprehet në themel.
167. Në lidhje me pretendimin se gjykata nuk ka marrë në konsideratë përcaktimin sipas nenit 203/2 të Kodit të Procedurës Civile, duke pranuar kërkesën për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, referuar nenit 203 të Kodit të Procedurës Civile: “*Sigurimi i padisë lejohet për të gjitha llojet e padive dhe në çdo fazë të gjykimit, derisa vendimi të marrë formë të prerë. Sigurimi i padisë lejohet edhe nga Gjykata e Apelit, kur padia është duke u shqyrtuar prej saj.*”
168. Edhe lidhur me këtë denoncim nuk janë konstatuar *indicie* për thellimin e hetimit, pasi denoncimi nuk referon ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit, sikurse as Gjykata e Apelit nuk ka ngritur dyshime mbi shkelje të mundshme

⁴¹Nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 19.5.2021.

⁴²Dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat nëpërmjet shkresës me nr. *** prot., datë 28.5.2021.

procedure, ndërkohë që denoncimi në fjalë i referohet themelit të çështjes gjyqësore që nuk është objekt i procesit të rivlerësimit.

6. Denoncimi nr. * prot., datë 7.12.2020, i shtetasve F. H. dhe K. H.**

169. Shtetasit F. H. dhe K. H. kanë depozituar denoncimin, në të cilin ngrenë pretendime për vendimmarrje të padrejtë nga subjekti i rivlerësimit në vendimin nr. ***, datë 13.3.2017. Nëpërmjet vendimit të sipërcituar gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit dhe shpenzimet gjyqësore i janë ngarkuar paditësit. Denoncuesit kanë pretenduar marrjen e masave ndaj subjektit të rivlerësimit, duke përshkruar si shkelje procedurale mosmarrjen në konsideratë të përcaktimeve të nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile.
170. Me qëllim thellimin në hetimin administrativ, Komisioni i është drejtuar me kërkesë⁴³ gjykatës për vënien në dispozicion të kopjes së vendimit. Nga shqyrtimi i vendimit⁴⁴ ka rezultuar se gjykata, në arsyetimin e vendimit, konkretisht ,në faqen nr. *** të tij, ka analizuar nenin 175/2 të Kodit të Procedurës Civile, shkaqet e mosparaqitjes së paditësit, megjithëse ky i fundit ka pasur dijeni të plotë dhe të rregullt për zhvillimin e seancës gjyqësore, si dhe nëse mosparaqitja ka ndodhur për ndonjë shkak të ligjshëm. Marrja dijeni ka rezultuar e provuar nëpërmjet procesverbalit të seancës së mëparshme gjyqësore, zhvilluar në datën 20.2.2018, në të cilën kanë qenë prezent paditësit dhe përfaqësuesit e tyre.
171. Subjekti i rivlerësimit, në vendimin e sipërcituar, ka arsyetuar se ka marrë në konsideratë përcaktimet e nenit 299/c. Në referencë të kësaj dispozite ka vendosur pushimin e gjykimit, sikurse është e përcaktuar shprehimisht në ligj. Subjekti, bazuar në nenin 179, pasi ka pyetur edhe palën e paditur, e cila ka kërkuar pushimin e gjykimit – ka vlerësuar se gjykimi i çështjes duhej pushuar. Vendimi i sipërcituar nuk është ankimuar në Gjykatën e Apelit dhe, për rrjedhojë, ka marrë formë të prerë. Në vlerësim të fakteve të paraqitura duket se nuk konstatohen problematika apo shkelje të subjektit dhe nuk ka *indicie* për hetime të mëtejshme lidhur me veprimet apo mosveprimet profesionale të subjektit të rivlerësimit.
172. Nisur nga sa më lart, duke vlerësuar sa ka rezultuar nga aktet dhe dokumentet e administruara, si dhe duke mbajtur në vëmendje shpjegimet e paraqitura nga subjekti, trupi gjykues çmon se nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksionit të saj.
173. Trupi gjykues, në këto kushte, pasi ka çmuar faktet dhe rrethanat që lidhen me aktet e shqyrtuara më herët nga KLGJ-ja, si dhe denoncimet nga publiku, nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit profesional, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin që nuk kanë rezultuar shkelje të rënda të subjektit dhe problematikat e konstatuara nuk mund të përbëjnë shkak për një vlerësim më të ulët se niveli minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, të përcaktuara nga pika 1/c, e nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmon se referuar nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 subjekti i rivlerësimit Adelajda

⁴³Nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 19.5.2021.

⁴⁴Dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat nëpërmjet shkresës me nr. *** prot., datë 28.5.2021.

Gjuzi është e aftë dhe ka arritur një nivel kualifikues lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Adelajda Gjuzi:

- a. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Komisioni, në këto kushte, bazuar në provat që disponon në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit Adelajda Gjuzi, duhet të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe nenit 59, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Adelajda Gjuzi, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 7.9.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma FASKAJ
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi